Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

ANALIZA NË FUSHËN E TREGTISË DHE BIZNESEVE SIPAS SHTATË (7) RAJONEVE ZHVILLIMORE



Korrik, 2026

Punuar nga:

Shyhrete Kastrati, Drejtoreshë e Departamentit për Përformancë dhe Analiza Rajonale

Fatmire Thaçi, Udhëheqëse e Divizionit për Performancë të Zhvillimit Rajonal të Balancuar

Copyright. 2026 – Ministria e Zhvillimit Rajonal

Republika e Kosovës, 10 000 Prishtinë

Kati: III Ndërtesa ish Rilindja, Prishtinë

Tel: +383(0)38 200 64 526

https://mzhr.rks-gov.net/

PËRMBAJTJA:

- **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4**
- **HYRJA DHE QËLLIMI 5**
- **METODOLOGJIA 6**
- **BIZNESET NË KOSOVË 7**
  - NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2026 7
  - TABELA 1 DHE GRAFIKONI: BIZNESET E REGJISTRUARA SIPAS RAJONEVE DERI ME 31.12.2025 8
  - NUMRI I BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 9
  - TABELA 2 DHE GRAFIKONI: REGJISTRIMI I BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 SIPAS RAJONEVE 10
  - LLOJET E BIZNESEVE TE REGJISTRUARA NË VITIN 2025 11
  - TABELA 3 DHE GRAFIKONI: LLOJET E BIZNESEVE TE REGJISTRUARA NE VITIN 2025 12
  - BIZNESET E REGJISTRUARA SIPAS SEKTORËVE NË VITIN 2025 12
  - TABELA 4 DHE GRAFIKONI: REGJISTRIMET SIPAS SEKTORËVE, 2025 13
  - BIZNESET E REGJISTRUARA SIPAS MUAJVE NË VITIN 2025 14
  - TABELA 5 DHE GRAFIKONI: REGJISTRIMET E BIZNESEVE TE REJA GJATË VITIT 2025 SIPAS MUAJVE 15
  - NUMRI I NDËRMARRJEVE TE MESME DHE TE VOGLA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 16
  - TABELA 6 DHE GRAFIKONI: REGJISTRIMET E NVM TE REJA SI DHE NUMRI I REGJISTRIMIT TË PUNËTORËVE GJATË VITIT 2025 SIPAS RAJOJNEVE 17
  - NUMRI I BIZNESEVE TË SHUARA GJATË VITIT 2025 18
  - TABELA 7 DHE GRAFIKONI: NUMRI I BIZNESEVE TE SHUARA SIPAS KOMUNAVE DHE RAJONEVE GJATË VITIT 2025 19
  - RAPORTI I BIZNESEVE TË REJA DHE BIZNESEVE TË SHUARA – 2025 20
  - TABELA 8 DHE GRAFIKONI: RAPORTI I BIZNESEVE TË REJA NDAJ BIZNESEVE TË SHUARA DHE % E SHUARJEVE TE BIZNESEVE NË SHTATË RAJONET ZHVILLIMORE 21
  - NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA DHE TREGUESIT RELATIV TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS RAJONEVE 22
  - TABELA 9 DHE GRAFIKONI: NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA DHE TREGUESIT RELATIV TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS RAJONEVE 23
  - BIZNESET E REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE DHE RAJONEVE ZHVILLIMORE 24
  - TABELA 10 DHE GRAFIKONI: REGJISTRIMET E BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS RAJONEVE 25
  - TREGU I PUNËS 26
  - TABELA 11 DHE GRAFIKONI: STRUKTURA E PUNËKËRKUESVE TË REGJISTRUAR SIPAS KUALIFIKIMIT NË VITIN 2025 26
  - TABELA 12 DHE GRAFIKONI: PUNËKËRKUESIT E REGJISTRUAR SIPAS GRUPMOSHËS NË VITIN 2025 27
  - IMPORTI DHE EKSPORTI I MALLRAVE 2025 28
  - TABELA 13 DHE GRAFIKONI: VLERA E IMPORTIT DHE EKSPORTIT 28
- **PËRFUNDIME 29**
- **REKOMANDIME 30**
  - SHTOJCAT: 31
  - SHTOJCA1: NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA DERI ME DATËN 31.12.2025 31
  - SHTOJCA2: NUMRI I BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 34
  - SHTOJCA 3: NUMRI I NDËRMARRJEVE TE MESME DHE TE VOGLA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE NË RAJONET ZHVILLIMORE 38
  - SHTOJCA 4: NUMRI I BIZNESEVE TË SHUARA GJATË VITIT 2025 41
  - SHTOJCA 5: NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA, SI DHE TREGUESIT RELATIV TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE, VITI 2025 45
  - SHTOJCA 6: BIZNESET E REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONEVE ZHVILLIMORE 49

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Analiza në fushën e Tregtisë dhe Bizneseve në shtatë rajonet zhvillimore të Republikës së Kosovës ka për qëllim vlerësimin e gjendjes, strukturës dhe dinamikës së aktivitetit biznesor në nivel rajonal dhe komunal, përmes shqyrtimit të treguesve që pasqyrojnë zhvillimin e sektorit të bizneseve dhe tregtisë gjatë vitit 2025.

Qëllimi kryesor i kësaj analize është identifikimi i dallimeve dhe karakteristikave të zhvillimit të aktivitetit biznesor ndërmjet rajoneve zhvillimore, vlerësimi i dinamikës së regjistrimit dhe shuarjes së bizneseve, si dhe evidentimi i kontributit të bizneseve të reja në krijimin e mundësive të punësimit. Në këtë mënyrë, analiza synon të ofrojë informacione relevante për vlerësimin e performancës rajonale dhe mbështetjen e politikave për zhvillim të balancuar rajonal.

Në kuadër të analizës janë shqyrtuar treguesit kryesorë që ndërlidhen me:

- Numrin e përgjithshëm të bizneseve të regjistruara deri më 31.12.2025 dhe shpërndarjen e tyre sipas rajoneve dhe komunave;
- Numrin e bizneseve të reja të regjistruara gjatë vitit 2025;
- Numrin e bizneseve të shuara gjatë vitit 2025;
- Bilancin ndërmjet regjistrimeve të reja dhe shuarjeve të bizneseve;
- Strukturën e bizneseve sipas veprimtarive ekonomike;
- Numrin e bizneseve të regjistruara, bizneseve të reja dhe të shuara, si dhe të treguesve relativë të zhvillimit të bizneseve sipas shtatë rajoneve zhvillimore përfshirë numrin e bizneseve për 1,000 banorë, normën e regjistrimit dhe normën e shuarjes së bizneseve.
- Regjistrimet e reja në sektorin e tregtisë dhe shpërndarjen e tyre territoriale;
- Numrin e punëtorëve të deklaruar nga bizneset e reja gjatë regjistrimit.

Gjatë vitit 2025, në Republikën e Kosovës janë regjistruar gjithsej 13,123 biznese të reja, prej të cilave 13,085 janë klasifikuar si ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme, që përbëjnë rreth 99.71% të numrit të përgjithshëm të bizneseve të reja të regjistruara gjatë kësaj periudhe.

Krahasimi ndërmjet shtatë rajoneve zhvillimore mundëson identifikimin e dallimeve në shpërndarjen dhe përqendrimin e aktivitetit biznesor, në dinamikën e regjistrimit dhe shuarjes së bizneseve, si dhe në strukturën e veprimtarive ekonomike. Vëmendje e veçantë i kushtohet sektorit të tregtisë, përmes analizimit të bizneseve të reja të regjistruara në këtë sektor dhe shpërndarjes së tyre sipas rajoneve dhe komunave.

Analiza e këtyre treguesve ofron një pasqyrë mbi zhvillimin e aktivitetit biznesor dhe dallimet territoriale ndërmjet rajoneve, duke krijuar mundësi për identifikimin e rajoneve me aktivitet më të theksuar biznesor, si dhe të atyre që kanë nevojë për mbështetje dhe masa të veçanta zhvillimore.

Në përfundim, kjo analizë përbën një bazë të rëndësishme për vlerësimin e zhvillimit të tregtisë dhe aktivitetit biznesor në shtatë rajonet zhvillimore të Republikës së Kosovës, si dhe për orientimin e politikave dhe masave mbështetëse drejt fuqizimit të sektorit privat dhe zvogëlimit të dallimeve në zhvillimin ekonomik rajonal.

HYRJA DHE QËLLIMI

Tregtia dhe sektori i biznesit përbëjnë një komponent të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik të Kosovës, duke kontribuar në krijimin e vendeve të punës, gjenerimin e të ardhurave, zhvillimin e sektorit privat dhe lidhjen e ekonomisë vendore me tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.

Analiza e tregtisë dhe bizneseve është e rëndësishme jo vetëm për vlerësimin e aktivitetit ekonomik në nivel vendi, por edhe për identifikimin e dallimeve ndërmjet shtatë rajoneve zhvillimore të Kosovës. Në kuadër të vlerësimit të zhvillimit socio-ekonomik rajonal, Ministria e Zhvillimit Rajonal ka përgatitur dokumentin "Analiza në Fushën e Tregtisë dhe Bizneseve Sipas Shtatë Rajoneve Zhvillimore", bazuar në të dhënat e ofruara nga institucionet përkatëse. Analiza synon të ofrojë një pasqyrë të gjendjes dhe zhvillimit të sektorit të tregtisë dhe aktivitetit biznesor në nivel rajonal dhe komunal. Në kuadër të analizës trajtohen treguesit kryesorë të tregtisë përfshirë importin, eksportin dhe bilancin tregtar si dhe treguesit që lidhen me regjistrimin dhe shuarjen e bizneseve, shpërndarjen e tyre, strukturën e aktivitetit ekonomik dhe ndikimin e bizneseve të reja në krijimin e vendeve të punës. Përmes analizimit dhe krahasimit të këtyre të dhënave ndërmjet shtatë rajoneve zhvillimore, synohet të evidentohen dallimet, karakteristikat dhe tendencat kryesore të zhvillimit të tregtisë dhe aktivitetit biznesor në nivel rajonal.

Analiza përfshin Rajonin Qendër, Rajonin Veri, Rajonin Perëndim, Rajonin Jug, Rajonin Juglindje, Rajonin Lindje dhe Rajonin Jugperëndim, duke mundësuar krahasimin e zhvillimit të biznesit ndërmjet rajoneve dhe komunave përkatëse. Vëmendje e veçantë i kushtohet sektorit të tregtisë, si një prej aktiviteteve kryesore ekonomike, përmes analizimit të regjistrimeve të reja në tregti dhe shpërndarjes së tyre sipas rajoneve dhe komunave. Në këtë mënyrë, analiza synon të identifikojë karakteristikat kryesore të strukturës territoriale të biznesit dhe ndryshimet ndërmjet rajoneve.

Të dhënat e përdorura në këtë analizë ofrojnë një pasqyrë të gjithanshme të gjendjes dhe dinamikës së aktivitetit biznesor, duke përfshirë: numrin e bizneseve, regjistrimet dhe shuarjet e bizneseve, punësimin e krijuar nga bizneset e reja etj. Analiza e këtyre treguesve krijon bazë për vlerësimin e zhvillimit dhe të dinamikës së sektorit privat në shtatë rajonet zhvillimore.

Qëllimi i kësaj analize është të vlerësojë gjendjen, strukturën dhe dinamikën e tregtisë dhe sektorit të biznesit në shtatë rajonet zhvillimore të Republikës së Kosovës, duke evidentuar dallimet dhe karakteristikat kryesore të zhvillimit ekonomik ndërmjet rajoneve dhe komunave.

Në mënyrë të veçantë, analiza synon:

- Të paraqesë shpërndarjen e bizneseve sipas shtatë rajoneve zhvillimore dhe komunave;
- Të evidentojë numrin dhe shpërndarjen e bizneseve të reja të regjistruara gjatë vitit 2025;
- Të evidentojë numrin dhe shpërndarjen e bizneseve të shuara gjatë vitit 2025;
- Të vlerësojë bilancin ndërmjet regjistrimeve të reja dhe shuarjeve të bizneseve;
- Të analizojë zhvillimin e sektorit të tregtisë, me fokus të veçantë në regjistrimet e reja në këtë sektor;
- Të vlerësojë numrin e punëtorëve të regjistruar nga bizneset e reja gjatë vitit 2025;

- Të identifikojë përqendrimin e aktivitetit biznesor dhe dallimet ndërmjet rajoneve zhvillimore;
- Të ofrojë tregues dhe informacione relevante për vlerësimin dhe matjen e performancës rajonale;
- Të krijojë një bazë analitike për identifikimin e fushave me nevojë për ndërhyrje dhe masa mbështetëse, me qëllim nxitjen e zhvillimit të sektorit privat dhe të zhvillimit më të balancuar rajonal etj.

Në këtë kuadër, analiza nuk kufizohet vetëm në paraqitjen e numrit të bizneseve, por synon të pasqyrojë dinamikën e hyrjes dhe daljes së bizneseve nga tregu, strukturën e aktivitetit ekonomik dhe lidhjen e zhvillimit të biznesit me punësimin, duke mundësuar një vlerësim më të plotë të gjendjes së sektorit të biznesit në rajonet zhvillimore.

METODOLOGJIA

Analiza e tregtisë dhe bizneseve në shtatë rajonet zhvillimore është realizuar përmes mbledhjes, sistemimit, përpunimit dhe analizimit të të dhënave statistikore dhe administrative lidhur me aktivitetin biznesor dhe tregtar gjatë vitit 2025. Analiza është orientuar drejt evidentimit të gjendjes, strukturës dhe dinamikës së bizneseve në nivel rajonal dhe komunal, si dhe identifikimit të dallimeve ndërmjet rajoneve zhvillimore. Analiza është zhvilluar në dy nivele: në nivel të rajoneve zhvillimore dhe në nivel të komunave që përbëjnë secilin rajon.

Në analizën e të dhënave është përdorur qasja përshkruese dhe krahasuese, duke evidentuar numrin, pjesëmarrjen në total, shpërndarjen territoriale dhe ndryshimet ndërmjet rajoneve dhe komunave. Përqindjet janë llogaritur në raport me totalin përkatës të shtatë rajoneve.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar sektorit të tregtisë, përmes analizimit të numrit të bizneseve të reja të regjistruara në këtë sektor dhe shpërndarjes së tyre nëpër rajone dhe komuna. Kjo mundëson identifikimin e përqendrimit territorial të aktivitetit të ri tregtar dhe rolin e tij në strukturën e përgjithshme të regjistrimeve të reja të bizneseve.

Numri i punëtorëve i deklaruar nga bizneset gjatë procesit të regjistrimit në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) nuk pasqyron domosdoshmërisht numrin real të personave të punësuar. Këto të dhëna paraqesin numrin e punëtorëve të deklaruar në momentin e regjistrimit të biznesit dhe nuk garantojnë se ky numër përputhet me gjendjen faktike të punësimit gjatë vitit 2025.

Gjatë vitit 2025 janë regjistruar gjithsej 13,123 biznese të reja, prej të cilave 13,085 janë klasifikuar si ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme (NVM), që përbëjnë rreth 99.71% të numrit të përgjithshëm të bizneseve të regjistruara gjatë kësaj periudhe. Ky klasifikim i referohet bizneseve të regjistruara gjatë vitit 2025 dhe pasqyron kategorizimin e paraqitur në platformën Open Data – ARBK.

Rezultatet e analizës paraqiten përmes tabelave dhe grafikëve, në mënyrë që të jenë më të lehta për tu kuptuar dhe krahasuar. Për secilin tregues shpjegohen rezultatet kryesore, duke treguar se si janë të shpërndara bizneset në rajone dhe komuna, ku është përqendruar aktiviteti biznesor dhe çfarë dallimesh ekzistojnë ndërmjet rajoneve në fushën e tregtisë dhe bizneseve.

BIZNESET NË KOSOVË

NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2026

Tabela paraqet numrin e bizneseve të regjistruara deri më 31 dhjetor 2025, të shpërndara në 38 komuna dhe të grupuara në shtatë rajonet zhvillimore të Kosovës. Sipas të dhënave të paraqitura, numri i përgjithshëm i bizneseve të regjistruara është 226,486, ndërsa 21 biznese janë të evidentuara pa komunë të përcaktuar. Të dhënat tregojnë një shpërndarje të pabarabartë rajonale të bizneseve, me përqendrim të theksuar në Rajonin Qendër, dhe në veçanti në Komunën e Prishtinës. Në të kundërtën, komunat me numër më të vogël të bizneseve paraqesin një bazë më të kufizuar të aktivitetit biznesor.

Rajoni Qendër ka numrin më të madh të bizneseve, me 92,288, që përbëjnë rreth 40,7% të totalit. Kjo do të thotë se rreth 4 në 10 biznese të regjistruara janë të përqendruara në këtë rajon.

Rajoni Juglindje renditet i dyti me 25,513 biznese (11,3%), pasuar nga Rajoni Jug me 24,146 (10,7%), Rajoni Perëndim me 22,756 (10,0%), Rajoni Veri me 22,270 (9,8%) dhe Rajoni Lindje me 21,759 (9,6%). Rajoni Jugperëndim ka numrin më të ulët, me 17,733 biznese, ose 7,8% të totalit.

Rajoni Qendër ka një përqendrim të madhe te aktivitetit biznesor, Prishtina paraqitet si qendra kryesore me 62,328 biznese, pra vetëm Prishtina përfaqëson rreth 27,5% të gjitha bizneseve të regjistruara në nivel te gjitha komunave të Republikës së Kosovës.

Prishtina ka gjithashtu një peshë shumë të madhe brenda Rajonit Qendër, nga 92,288 bizneset e këtij rajoni, rreth 67,5% janë të regjistruara në Prishtinë. Ky koncentrim mund të lidhet me madhësinë e tregut, përqendrimin e konsumatorëve, institucionet publike, infrastrukturën, etj.

Pas Prishtinës, numrin më të madh të bizneseve e kanë: Ferizaji me 18,189 biznese, Prizreni me 18,112 biznese, Gjilani me 13,276 biznese, Peja me 12,678 biznese, Gjakova me 10,213 biznese, Mitrovica me 8,846 biznese, Fushë Kosova me 7,668 biznese, Podujeva me 6,953 biznese, Lipjani me 6,222 biznese dhe Vushtrria me 5,851 biznese.

Këto komuna përfaqësojnë qendrat kryesore urbane dhe ekonomike të rajoneve përkatëse. Prishtina, Ferizaj dhe Prizreni së bashku kanë 98,629 biznese, që përbëjnë rreth 43,5% të totalit bizneseve.

Komunat me numër shumë më të vogël biznesesh janë: Kllokoti me 81 biznese, Ranillugu me 56 biznese dhe Parteshi me 45 biznese.

Diferenca ndërmjet Rajonit Qendër dhe Rajonit Jugperëndim është 74,555 biznese qe i bie se Rajoni Qendër ka rreth 5,2 herë më shumë biznese se Rajoni Jugperëndim.

Megjithatë, krahasimi ndërmjet gjashtë rajoneve, pa Rajonin Qendër, tregon një shpërndarje dukshëm më të ekuilibruar.

Të dhënat deri më 31.12.2025 tregojnë se aktiviteti biznesor në Kosovë është i shpërndarë në të gjitha rajonet zhvillimore, por me një përqendrim të theksuar në Rajonin Qendër. Ky rajon përfshin 40,7% të bizneseve të paraqitura në tabelë, ndërsa Prishtina vetë përfaqëson 27,5% të totalit. Ferizaj, Prizreni,


Gjilani, Peja, Gjakova dhe Mitrovica paraqiten si qendra të tjera të rëndësishme të aktivitetit biznesor. Në anën tjetër, komunat më të vogla kanë numër dukshëm më të ulët të bizneseve të regjistruara.

Këto të dhëna evidentojnë rëndësinë e qendrave urbane në përqendrimin e aktivitetit biznesor dhe njëkohësisht nevojën për politika që mbështesin zhvillimin e bazës biznesore edhe në komunat dhe rajonet me nivel më të ulët të aktivitetit.

TABELA 1 DHE GRAFIKONI: BIZNESET E REGJISTRUARA SIPAS RAJONEVE DERI ME 31.12.2025[1]

TABELA ME NUMRIN E BIZNESEVE TE REGJISTRUARA SIPAS RAJONEVE DERI ME 31.12.2025

RAJONET	NUMRI I BIZNESEVE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	% E BIZNESEVE SIPAS RAJONEVE
RAJONI QENDËR	92,288	40.7
RAJONI VERI	22,270	9.8
RAJONI PERENDIM	22,756	10.0
RAJONI JUG	24,146	10.7
RAJONI JUGLINDJE	25,513	11.3
RAJONI LINDJE	21,759	9.6
RAJONI JUGPERENDIM	17,733	7.8
PA KOMUNË	21	0.0
GJITHSEJ	**226,486**	**100.00**



[1] Burimi: Agjencia e regjistrimit te bizneseve – ARBK, Data Open 16.09.2026.

NUMRI I BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025

Tabela paraqet numrin e bizneseve të reja të regjistruara dhe numrin e punëtorëve të regjistruar në këto biznese gjatë vitit 2025, sipas 38 komunave dhe shtatë rajoneve zhvillimore. Në total janë regjistruar 13,123 biznese të reja, të cilat kanë deklaruar gjithsej 22,199 punëtorë. Të dhënat tregojnë një aktivitet të konsiderueshëm në krijimin e bizneseve të reja gjatë vitit 2025.

Megjithatë, shpërndarja e bizneseve të reja dhe vendeve të punës nuk është e njëjtë ndërmjet rajoneve. Një pjesë e konsiderueshme e aktivitetit të ri biznesor është e përqendruar në Rajonin Qendër, ndërsa rajonet e tjera paraqesin nivele më të ulëta të regjistrimeve.

Rajoni Qendër paraqet nivelin më të lartë të regjistrimeve të bizneseve të reja. Në komunat e këtij rajoni janë regjistruar gjithsej 6,147 biznese të reja, me 11,219 punëtorë të regjistruar.

Brenda rajonit dallon veçanërisht Prishtina, me 4,222 biznese të reja dhe 8,199 punëtorë. Pas saj vjen Fushë Kosova me 669 biznese dhe 986 punëtorë, ndërsa Podujeva me 421 biznese dhe 679 punëtorë.

Rajoni Qendër përfaqëson rreth 46.8% të të gjitha bizneseve të reja dhe rreth 50.53% të punëtorëve të regjistruar në të gjithë Republikën e Kosovës.

Në Rajonin Veri janë regjistruar gjithsej 1,291 biznese të reja, me 1,740 punëtor. Mitrovica ka numrin më të madh të regjistrimeve në këtë rajon, me 453 biznese dhe 617 punëtorë, e ndjekur nga Vushtrria me 304 biznese dhe 401 punëtorë dhe Skenderaj me 173 biznese dhe 264 punëtorë.

Rajoni përfaqëson rreth 9.83% të bizneseve të reja dhe 7.83% të punëtorëve të regjistruar.

Në Rajonin Perëndim janë regjistruar 944 biznese të reja dhe 1,613 punëtorë. Peja paraqet numrin më të lartë me 543 biznese dhe 956 punëtorë, ndërsa Istogu ka 157 biznese dhe 259 punëtorë, Klina 141 biznese dhe 251 punëtorë dhe Deçani 103 biznese dhe 147 punëtorë.

Rajoni përbën rreth 7.2% të bizneseve të reja dhe 7.3% të punëtorëve të regjistruar.

Në Rajonin Jug janë regjistruar 1,325 biznese të reja dhe 1,930 punëtorë. Prizreni është komuna me numrin më të madh të regjistrimeve, me 944 biznese të reja dhe 1,418 punëtorë. Suhareka pason me 295 biznese dhe 394 punëtorë, ndërsa Dragashi ka 47 biznese me 65 puntorë dhe Mamusha ka 39 biznese të reja me 53 puntorë.

Rajoni përbën rreth 10.09% të bizneseve të reja dhe 8.7% të punëtorëve të regjistruar.

Rajoni Juglindje ka gjithsej 1,477 biznese të reja dhe 2,463 punëtorë, duke përfaqësuar rreth 11.25% të bizneseve të reja dhe 11.09% të punëtorëve të regjistruar. Ferizaj dominon aktivitetin e ri biznesor në këtë rajon me 1,133 biznese të reja dhe 1,928 punëtorë. Shtimja ka 126 biznese, Kaçaniku 151, Shtërpca 21, ndërsa Hani i Elezit 46.

Në Rajonin Lindje janë regjistruar 1,075 biznese të reja dhe 1,854 punëtorë. Gjilani ka pjesën kryesore të regjistrimeve, me 733 biznese dhe 1,292 punëtorë. Pas tij vijnë Vitia me 183 biznese, Kamenica me 123, Novobërda me 17, Kllokoti me 10, Ranillugu me 7 dhe Parteshi me 2 biznese të reja.

Rajoni përfaqëson rreth 8.19% të bizneseve të reja dhe 8.35% të punëtorëve të regjistruar.

Në Rajonin Jugperëndim janë regjistruar 864 biznese të reja dhe 1,380 punëtorë. Gjakova ka numrin më të madhe të regjistrimeve me 476 biznese dhe 757 punëtorë, e ndjekur nga Malisheva me 196 biznese dhe 340 punëtorë, Rahoveci me 174 biznese dhe 259 punëtorë, ndërsa Juniku ka 18 biznese dhe 24 punëtorë.

Rajoni përbën rreth 6.58% të bizneseve të reja dhe 6.21% të punëtorëve të regjistruar.

Rajoni Qendër ka pjesën më të madhe të regjistrimeve, me 6,147 biznese të reja, ndërsa Juglindja renditet pas tij me 1,477 dhe Jugu me 1,325. Në anën tjetër, numri më i ulët i bizneseve të reja është regjistruar në Jugperëndim, me 864 biznese.

Në aspektin e punësimit, Qendra gjithashtu ka numrin më të madh, me 11,219 punëtorë, ndërsa pas saj vijnë Juglindja me 2,463, Jugu me 1,930 dhe Lindja me 1,854.

Kjo shpërndarje tregon se aktiviteti i ri ekonomik është i lidhur ngushtë me madhësinë dhe rëndësinë ekonomike të qendrave kryesore urbane.

Një karakteristikë e rëndësishme e të dhënave është dominimi i disa komunave brenda secilit rajon: Prishtina me 4,222 biznese të reja, Prizreni 944, Ferizaji 1,133, Gjilani 733, Peja 543, Gjakova 476, dhe Mitrovicë 453 biznese të reja. Këto shtatë qendra së bashku përbëjnë rreth 8,504 biznese të reja, ose afërsisht 64.80% të totalit të regjistrimeve. Kjo tregon një përqendrim të konsiderueshëm të krijimit të bizneseve të reja në qendrat kryesore komunale.

Këto të dhëna evidentojnë dallime të konsiderueshme në shpërndarjen e aktivitetit të ri biznesor dhe të punësimit të lidhur me këto biznese. Rajoni Qendër ka përqendrimin më të madh të regjistrimeve, duke përbërë rreth 46.8% të bizneseve të reja dhe 50.5% të punëtorëve të regjistruar në totalin e paraqitur. Në rajonet e tjera, aktiviteti është më i shpërndarë dhe në masë të konsiderueshme i përqendruar në qendrat kryesore urbane.


Prania e dallimeve rajonale në numrin e bizneseve të reja dhe në numrin e punëtorëve të regjistruar tregon rëndësinë e analizimit të aktivitetit në nivel komunal dhe rajonal. Për qëllimet e zhvillimit të balancuar rajonal, këto të dhëna mund të shërbejnë si bazë për identifikimin e zonave me aktivitet më të lartë të krijimit të bizneseve, si dhe të komunave ku niveli i regjistrimeve të reja është më i ulët.

TABELA 2 DHE GRAFIKONI: REGJISTRIMI I BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 SIPAS RAJONEVE[2]

TABELA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 SIPAS RAJONEVE

RAJONET	REGJISTRIME TE BIZNESEVE TË REJA 2025	PUNËTORË – REGJISTRIME 2025
RAJONI QENDËR	6,147	11,219
RAJONI VERI	1,291	1,740
RAJONI PERENDIM	944	1,613
RAJONI JUG	1,325	1,930
RAJONI JUGLINDJE	1,477	2,463
RAJONI LINDJE	1,075	1,854
RAJONI JUGPERENDIM	864	1,380
GJITHSEJ	**13,123**	**22,199**

[2] Burimi: Agjencia e regjistrimit te bizneseve – ARBK, Data Open 16.09.2026.



LLOJET E BIZNESEVE TE REGJISTRUARA NË VITIN 2025

Të dhënat për vitin 2025 tregojnë se në Kosovë janë regjistruar gjithsej 13,123 biznese të reja, të organizuara në forma të ndryshme juridike. Struktura e regjistrimeve tregon një përqendrim shumë të madhë në dy forma kryesore: Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuara dhe Bizneset Individuale.


Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuara (SHPK) përbëjnë formën dominuese të bizneseve të reja të regjistruara në vitin 2025. Nga gjithsej 13,123 regjistrime, 9,769 janë SH.P.K. që përbëjnë 74.4% të gjitha regjistrimeve. Kjo do të thotë se afërsisht tre nga çdo katër biznese të reja janë regjistruar në formën e SHPK-së. Pesha prej 74.4% tregon se kjo formë juridike përfaqëson strukturën kryesore të organizimit të bizneseve të reja të regjistruara në vitin 2025.

Bizneset individuale përbëjnë grupin e dytë më të madhe, me 3,288 regjistrime, ose 25.1% të totalit. Kështu, së bashku SH.P.K.-të dhe bizneset individuale përbëjnë 99.5% të të gjitha bizneseve të regjistruara. Kjo tregon një përqendrim shumë të lartë të regjistrimeve të reja në këto dy forma, ndërsa format e tjera kanë një pjesëmarrje shumë të kufizuar.

Llojet e tjera të biznesit kanë pjesëmarrje shumë më të vogël: Degët e shoqërive të huaja: 50 regjistrime, ose 0.4%; Shoqëritë aksionare: 11 regjistrime, ose 0.1%; Zyrat e përfaqësisë në Kosovë: 4 regjistrime; Ortakëritë e përgjithshme: 1 regjistrim. Në total, këto forma përfaqësojnë vetëm rreth 0.5% të regjistrimeve.

TABELA 3 DHE GRAFIKONI: LLOJET E BIZNESEVE TE REGJISTRUARA NE VITIN 2025[3]

LLOJET E BIZNESEVE TE REGJISTRUARA NE VITIN 2025		
LLOJI I BIZNESIT	**REGJISTRIME 2025**	**PJESËMARRJA**
SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA	9,769	74.4%
BIZNES INDIVIDUAL	3,288	25.1%
DEGA E SHOQËRISË SË HUAJ	50	0.4%
SHOQËRI AKSIONARE	11	0.1%
ZYRA E PËRFAQËSISË NË KOSOVË	4	0.0%
ORTAKËRI E PËRGJITHSHME	1	0.0%
GJITHSEJ	**13,123**	**100%**



BIZNESET E REGJISTRUARA SIPAS SEKTORËVE NË VITIN 2025

Gjatë vitit 2025 janë regjistruar gjithsej 13,123 biznese të reja në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Struktura e regjistrimeve tregon një përqendrim të konsiderueshëm në sektorët e tregtisë, industrisë përpunuese, ndërtimtarisë, aktiviteteve profesionale, shkencore dhe teknike, si dhe hotelerisë dhe akomodimit.

Sektori G4[5] – Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave ka numrin më të madh të regjistrimeve, me 3,112 biznese, që përbëjnë 23.71% të të gjitha regjistrimeve. Kjo tregon se tregtia ka pasur peshën më të madhe në krijimin e bizneseve të reja gjatë vitit 2025.

Në vendin e dytë renditet Industria përpunuese, me 1,451 biznese (11.06%), ndërsa Ndërtimtaria me 1,402 biznese (10.68%). Këta dy sektorë së bashku përfaqësojnë 21.74% të regjistrimeve të reja.

[3] Burimi: Agjencia e regjistrimit te bizneseve – ARBK, Data Open 16.09.2026.

[5] Kodet e seksioneve të aktiviteteve ekonomike sipas Klasifikimit të Aktiviteteve Ekonomike NACE Rev. 2. (Klasifikimi standard evropian për aktivitetet ekonomike).

Një pjesëmarrje të rëndësishme ka edhe Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike, me 1,366 biznese (10.41%), si dhe Hoteleria dhe akomodimi, me 1,237 biznese (9.43%).

Pra këta pesë sektorë me numrin më të madhe të regjistrimeve, kanë gjithsej 8,568 biznese të reja, ose rreth 65.3% të gjitha regjistrimeve. Kjo tregon një përqendrim të regjistrimeve të reja në një numër relativisht të kufizuar sektorësh ekonomikë.

Në grupin e sektorëve me pjesëmarrje të mesme përfshihen: Informimi dhe komunikimi (6.93%), Aktivitetet shërbyese dhe të përkrahjes (6.35%) dhe Aktivitetet tjera shërbyese (5.40%). Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi përbën 3.31%, ndërsa Transporti dhe magazinimi 3.15% të regjistrimeve.


Sektorët me pjesëmarrjen më të ulët janë: Administrimi publik dhe mbrojtja; sigurimi i detyruar social, me 17 biznese (0.13%), Ujësjellësi, kanalizimi dhe menaxhimi i mbeturinave, me 27 biznese (0.21%), dhe Xeheroret dhe gurëthyesit, me 29 biznese (0.22%). Gjithashtu, regjistrime te bizneseve me numër relativisht të vogël janë evidentuar në Aktivitetet financiare dhe të sigurimit (0.94%) dhe Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe klimatizim (0.95%).

Struktura e regjistrimeve të reja në vitin 2025 tregon se aktiviteti i ri biznesor është përqendruar kryesisht në tregti, industri përpunuese, ndërtimtari, aktivitete profesionale dhe hoteleri/akomodim. Këta sektorë përbëjnë pjesën kryesore të regjistrimeve të reja dhe paraqesin fushat me dinamiken më të madhe të krijimit të bizneseve gjatë vitit 2025, pra këto janë regjistrimet e reja të bizneseve gjate vitit 2025 në secilin sektor.

TABELA 4 DHE GRAFIKONI: REGJISTRIMET SIPAS SEKTORËVE, 2025[6]

REGJISTRIMET SIPAS SEKTORËVE, 2025		
SEKTORI	**REGJISTRIME 2025**	**PJESËMARRJA**
G - TREGTIA ME SHUMICE DHE PAKICE RIPARIMI I MJETEVE MOTORIKE DHE MOTOCIKLETAVE	3,112	23.71%
C - INDUSTRIA PERPUNUESE PRODHIMTARIA	1,451	11.06%
F - NDERTIMTARIA	1,402	10.68%
M - AKTIVITETET PROFESIONALE SHKENCORE DHE TEKNIKE	1,366	10.41%
I - HOTELERIA DHE AKOMODIMI	1,237	9.43%
J - INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI	909	6.93%
N - AKTIVITETET SHERBYESE DHE TE PERKRAHJES	833	6.35%
S - AKTIVITETET TJERA SHERBYESE	708	5.40%
A - BUJQESIA PYLLTARIA DHE PESHKIMI	435	3.31%
H - TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI	414	3.15%
Q - AKTIVITETET E SHENDETIT NJEREZOR DHE TE PUNES SOCIALE	332	2.53%
R - ARTET ARGETIMI DHE REKREACIONI	236	1.80%
L - AKTIVITETET E PATUNDSHMERISE	215	1.64%
P - ARSIMI	152	1.16%
D - FURNIZIMI ME RRYME GAZ AVULL DHE KLIMATIZIM	125	0.95%
K - AKTIVITETET FINANCIARE DHE TE SIGURIMIT	123	0.94%
B - XEHERORET DHE GURETHYESIT	29	0.22%
E - UJESJELLESI KANALIZIMI MENAXHIMI I MBETURINAVE DHE AKTIVITETET E RIPARIMIT	27	0.21%
O - ADMINISTRIMI PUBLIK DHE I MBROJTJES SIGURIMI I DETYRUAR SOCIAL	17	0.13%
	13,123	**100%**

[6]Burimi: Agjencia e regjistrimit te bizneseve – ARBK, Data Open 16.09.2026.



BIZNESET E REGJISTRUARA SIPAS MUAJVE NË VITIN 2025[7]

Të dhënat mujore tregojnë se ritmi i regjistrimit ka ndryshuar gjatë vitit, numri më i madh i regjistrimeve është realizuar në maj, me 1,333 biznese që përbën rreth 10.2% të gjitha regjistrimeve vjetore. Pas majit, numër të lartë regjistrimesh janë shënuar në korrik, me 1,315 biznese ose 10.02% , dhe në qershor me 1,151 biznese ose 8.77%. Në anën tjetër, numri më i ulët i regjistrimeve është evidentuar në nëntor, me 919 biznese ose 7%, pasuar nga janari me 959 biznese ose 7.31%dhe dhjetori me 1,000 biznese ose 7.62%.

Në fillim të vitit, regjistrimet janë rritur gradualisht nga 959 në janar, në 1,018 në shkurt, 1,038 në mars dhe 1,143 në prill, kjo rritje kulmon në maj me 1,333 regjistrime. Pas majit, regjistrimet mbeten në nivel relativisht të lartë edhe gjatë qershorit (1,151) dhe korrikut (1,315). Gjatë muajve gusht–tetor vërehet një

[7] Burimi: Agjencia e regjistrimit te bizneseve – ARBK, Data Open 16.09.2026.


nivel relativisht i qëndrueshëm. Në nëntor regjistrohet rënia më e theksuar, në 919 biznese, ndërsa në dhjetor ka një rritje të lehtë në 1,000 regjistrime.

Regjistrimet e bizneseve të reja gjatë vitit 2025 kanë shfaqur një ecuri përgjithësisht të qëndrueshme, me luhatje mujore. Në përgjithësi, numri i regjistrimeve është shpërndarë relativisht në mënyrë të qëndrueshme gjatë vitit, pa dallime ekstreme ndërmjet shumicës së muajve.

TABELA 5 DHE GRAFIKONI: REGJISTRIMET E BIZNESEVE TE REJA GJATË VITIT 2025 SIPAS MUAJVE

REGJISTRIMET E BIZNESEVE TE REJA GJATË VITIT 2025 SIPAS MUAJVE

NR.	MUAJT	REGJISTRIME TE BIZNESEVE TË REJA 2025	% E BIZNESEVE
1	JANAR	959	7.31%
2	SHKURT	1,018	7.76%
3	MARS	1,038	7.91%
4	PRILL	1,143	8.71%
5	MAJ	1,333	10.16%
6	QERSHOR	1,151	8.77%
7	KORRIK	1,315	10.02%
8	GUSHT	1,068	8.14%
9	SHTATOR	1,054	8.03%
10	TETOR	1,125	8.57%
11	NENTOR	919	7.00%
12	DHJETOR	1,000	7.62%
GJITHSEJ		**13,123**	**100%**



NUMRI I NDËRMARRJEVE TE MESME DHE TE VOGLA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025

Gjatë vitit 2025, sipas të dhënave të tabelës, janë regjistruar gjithsej 13,085 ndërmarrje të vogla dhe të mesme të reja, të cilat kanë regjistruar 21,199 punëtorë.

Të dhënat tregojnë se aktiviteti i NVM-ve të reja është i shpërndarë në shtatë rajonet zhvillimore, por me dallime të konsiderueshme ndërmjet rajoneve.

Rajoni Qendër ka numrin më të madh të NVM-ve të reja, me 6,132 NVM, të cilat kanë regjistruar 10,219 punëtorë. Kjo përfaqëson rreth 46.9% të gjitha NVM-ve të reja dhe 48.2% të punëtorëve të regjistruar në NVM-të e reja në shtatë rajonet.

Brenda rajonit, Prishtina ka numrin më të madh, me 4,218 NVM të reja dhe 7,199 punëtorë. Pas saj renditet Fushë Kosova me 667 NVM dhe 986 punëtorë, Podujeva me 420 NVM dhe 679 punëtorë, Lipjani me 321 NVM dhe 468 punëtorë dhe Gllogoci me 256 NVM dhe 400 punëtorë.

Prishtina vetëm përbën rreth 32.23% të gjitha NVM-ve të reja ne nivel vendi.

Në Rajonin Veri janë regjistruar 1,287 NVM të reja, me gjithsej 1,740 punëtorë. Rajoni përfaqëson rreth 9.83% të NVM-ve të reja dhe 8.2% të punëtorëve.

Në nivel komunal, Mitrovica ka numrin më të madh me 451 NVM të reja dhe 617 punëtorë, ndërsa Vushtrria ka 304 NVM dhe 401 punëtor. Skenderaj ka 172 NVM dhe 264 punëtorë.

Rajoni Perëndim ka regjistruar 941 NVM të reja dhe 1,613 punëtorë, rajoni përfaqëson 7.19% te NVM-ve te reja. Në këtë rajon, Peja ka peshën kryesore me 543 NVM të reja dhe 956 punëtorë. Pas saj vijnë Istogu me 155 NVM, Klina me 140 NVM dhe Deçani me 103 NVM.

Në Rajonin Jug janë regjistruar 1,321 NVM të reja, me 1,930 punëtorë, ky rajon ka 10.09% te NVM-ve. Prizreni dominon me NVM-të e reja me 940 NVM dhe 1,418 punëtorë, Suhareka ka 295 NVM dhe 394 punëtorë, ndërsa Dragashi dhe Mamusha kanë nga 47 dhe 39 NVM.

Rajoni Juglindje ka regjistruar 1,474 NVM të reja, me 2,463 punëtorë. Ky rajon përfaqëson rreth 11.26% të NVM-ve të reja dhe rreth 11.6% të punëtorëve.

Ferizaj është komuna dominuese, me 1,132 NVM të reja dhe 1,928 punëtorë, Kaçaniku ka 151 NVM, Shtimja 125, Hani i Elezit 45, ndërsa Shtërpca 21.

Rajoni Lindje ka gjithsej 1,071 NVM të reja dhe 1,854 punëtorë me 8.18% te NVM-ve. Gjilani ka numrin më të madh të NVM-ve të reja, me 730, dhe 1,292 punëtorë. Vitia ka 183 NVM, ndërsa Kamenica 122 NVM.

Në Rajonin Jugperëndim janë regjistruar 859 NVM të reja, me 1,380 punëtorë me 6.56% te NVM-ve. Gjakova ka 473 NVM të reja dhe 757 punëtorë, Malisheva 196 NVM dhe 340 punëtorë, ndërsa Rahoveci ka 173 NVM dhe 259 punëtorë. Juniku ka 17 NVM dhe 24 punëtorë.

Analiza tregon një përqendrim të dukshëm të aktivitetit të NVM-ve të reja në Rajonin Qendër. Me 6,132 NVM, ky rajon ka më shumë NVM të reja se të gjitha rajonet e tjera. Pas Rajonit Qendër, numrin më të madh të NVM-ve të reja e kanë: Juglindja me 1,474, Jugu me 1,321, Veriu me 1,287, Lindja me 1,071,

Perëndimi me 941 dhe Jugperëndimi me 859. Kjo shpërndarje tregon se aktiviteti i NVM-ve është më i përqendruar në qendrat më të mëdha urbane dhe ekonomike.


Sa i përket nivelit komunal, dallohen disa qendra me numrin me te madhe te NVM-ve të reja: Prishtina me 4,218 NVM, Ferizaj me 1,132 NVM, Prizreni me 940 NVM, Gjilani me 730 NVM, Fushë Kosova me 667 NVM, Peja me 543 NVM dhe Gjakova me 473 NVM.

Këto komuna kanë së bashku 8,703 NVM të reja, ose rreth 66.51% të totalit. Kjo tregon se pjesa më e madhe e krijimit të NVM-ve të reja është e përqendruar në një numër relativisht të kufizuar të qendrave komunale.

TABELA 6 DHE GRAFIKONI: REGJISTRIMET E NVM TE REJA SI DHE NUMRI I REGJISTRIMIT TË PUNËTORËVE GJATË VITIT 2025 SIPAS RAJOJNEVE[8]

TABELA E REGJISTRIMEVE TË NVM TË REJA SI DHE NUMRI I REGJISTRIMIT TË PUNËTORËVE GJATË VITIT 2025 SIPAS RAJONEVE

RAJONET	NVM TË REJA	PUNËTORË NË NVM TË REJA
RAJONI QENDËR	6,132	10,219
RAJONI VERI	1,287	1,740
RAJONI PERENDIM	941	1,613
RAJONI JUG	1,321	1,930
RAJONI JUGLINDJE	1,474	2,463
RAJONI LINDJE	1,071	1,854
RAJONI JUGPERENDIM	859	1,380
GJITHSEJ	**13,085**	**21,199**



[8] Burimi: Agjencia e regjistrimit te bizneseve – ARBK, Data Open 16.09.2026.

Në vitin 2025, në shtatë rajonet zhvillimore janë evidentuar gjithsej 1,349 biznese të shuara. Shuarjet përfaqësojnë daljen e bizneseve nga veprimtaria e regjistruar dhe, për këtë arsye, janë një tregues i rëndësishëm për analizën e dinamikës së sektorit të biznesit.

Rajoni Qendër ka numrin më të madh të bizneseve të shuara, gjithsej 453 biznese, që përbëjnë rreth 33.6% të të gjitha shuarjeve në shtatë rajonet. Kjo lidhet edhe me faktin se Rajoni Qendër ka bazën më të madhe të bizneseve. Brenda rajonit, Prishtina ka numrin më të madh të shuarjeve, me 248 biznese, Podujeva me 52, Gllogovci me 46 dhe Lipjani me 34. Në të njëjtën kohë, Rajoni Qendër ka pasur 6,147 biznese të reja, prandaj bilanci i hyrje-daljeve është pozitiv me 5,694 biznese.

Në Rajonin Veri janë shuar 222 biznese, ose rreth 16.5% e të gjitha bizneseve të shuara. Numrin më të madh e ka Mitrovica, me 92 biznese të shuara, pasuar nga Vushtrria me 62 dhe Skenderaj me 35. Rajoni ka pasur 1,291 biznese të reja dhe 222 të shuara. Bilanci është pozitiv me 1,069 biznese. Raporti i bizneseve të shuara ndaj bizneseve të reja është rreth 17.2%, më i larti ndër shtatë rajonet. Kjo do të thotë se për çdo 100 biznese të reja të regjistruara në këtë rajon janë evidentuar rreth 17 shuarje.

Në Rajonin Perëndim janë shuar 122 biznese, që përbëjnë rreth 9.0% të shuarjeve totale. Peja ka numrin më të madh, me 63 biznese të shuara, ndërsa Klina ka 25, Istogu 17 dhe Deçani 17. Në raport me 944 bizneset e reja, bilanci është pozitiv me 822 biznese. Kështu, numri i bizneseve të reja është dukshëm më i madh se numri i bizneseve të shuara.

Rajoni Jug ka evidentuar 182 biznese të shuara, ose rreth 13.5% të totalit. Prizreni ka 108 biznese të shuara dhe përbën pjesën kryesore të shuarjeve në rajon. Suhareka ka 56, Dragashi 17 dhe Mamusha vetëm 1. Me 1,325 biznese të reja dhe 182 biznese te shuara, bilanci është pozitiv me 1,143 biznese. Raporti i shuarjeve ndaj bizneseve të reja është rreth 13.7%.

Rajoni Juglindje paraqet një numër relativisht më të ulët të shuarjeve, me gjithsej 94 biznese, ose vetëm rreth 7.0% të shuarjeve në shtatë rajonet. Ferizaj ka 63 biznese të shuara, ndërsa Shtime dhe Kaçanik kanë nga 9, Shtërpca 7 dhe Hani i Elezit 6. Ky rajon ka pasur 1,477 biznese të reja, që është numër më i madh se në disa rajone me numër më të lartë shuarjesh. Bilanci është pozitiv me 1,383 biznese. Ky është bilanci i dytë më i madh pozitiv pas Rajonit Qendër.

Në Rajonin Lindje janë shuar 154 biznese, ose rreth 11.4% e totalit. Gjilani kryeson me 95 biznese të shuara, ndërsa Vitia ka 28 dhe Kamenica 25. Në komunat tjera numri është dukshëm më i ulët. Me 1,075 biznese të reja, rajoni ka bilanc pozitiv me 921 biznese. Raporti i shuarjeve ndaj bizneseve të reja është rreth 14.3%.

Në Rajonin Jugperëndim janë shuar 122 biznese, ose rreth 9.0% e totalit. Gjakova ka numrin më të madh me 73 biznese të shuara, e ndjekur nga Malisheva me 27 dhe Rahoveci me 21. Juniku ka vetëm 1 biznes të shuar. Rajoni ka pasur 864 biznese të reja, ndërsa 122 janë shuar. Bilanci është 742 biznese.

Në nivel të përgjithshëm: Biznese të reja: 13,123, Biznese të shuara: 1,349, Bilanci pozitiv 11,774 .Kjo paraqet një diferencë të konsiderueshme ndërmjet hyrjeve dhe daljeve të bizneseve gjatë vitit 2025.

Komunat me numrin më të madh të bizneseve të shuara janë: Prishtina 248, Prizren 108, Gjilan 95, Mitrovicë 92, Gjakovë 73, Pejë 63, Ferizaj 63, Vushtrri 62, Suharekë 56 dhe Podujevë 52. Vetëm Prishtina, Prizreni, Gjilani dhe Mitrovica kanë së bashku 543 biznese të shuara, që përbëjnë rreth 40.3% të totalit. Kjo tregon se shuarjet janë të përqendruara kryesisht në komunat më të mëdha urbane, ku edhe baza e bizneseve është më e madhe.


Komunat me numrin më të vogël të bizneseve të shuara janë: Parteshi 0, Novobërda 1, Mamusha 1, Juniku 1, Zubin Potok 2, Ranillugu 2, Kllokoti 3, Hani i Elezit 6, Shtërpca 7, Zveçani 8, Shtime 9 dhe Kaçaniku 9.

Numri i bizneseve të shuara duhet të analizohet duke marrë parasysh edhe numrin e përgjithshëm të bizneseve në secilin rajon. Rajonet që kanë më shumë biznese mund të kenë edhe më shumë biznese të shuara. Prandaj, përveç numrit të bizneseve të shuara, është e rëndësishme të llogaritet edhe përqindja e tyre në raport me numrin e përgjithshëm të bizneseve. Kjo mundëson një krahasim më të drejtë ndërmjet rajoneve dhe ndihmon për të kuptuar më mirë shkallën e shuarjes së bizneseve në secilin rajon.

TABELA 7 DHE GRAFIKONI: NUMRI I BIZNESEVE TE SHUARA SIPAS KOMUNAVE DHE RAJONEVE GJATË VITIT 2025[9]

TABELA ME NUMRIN E BIZNESEVE TE SHUARA SIPAS RAJONEVE GJATË VITIT 2025

RAJONET	NUMRI I BIZNESEVE TË SHUARA 2025	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË RAJONIT
RAJONI QENDËR	453	34%
RAJONI VERI	222	16%
RAJONI PERENDIM	122	9%
RAJONI JUG	182	13%
RAJONI JUGLINDJE	94	7%
RAJONI LINDJE	154	11%
RAJONI JUGPERENDIM	122	9%
GJITHSEJ	**1,349**	**100%**



[9] Burimi: Agjencia e regjistrimit te bizneseve – ARBK, Data Open 16.09.2026.

Të dhënat e mëposhtme paraqesin raportin ndërmjet bizneseve të reja të regjistruara dhe bizneseve të shuara gjatë vitit 2025 në shtatë rajonet zhvillimore. Në nivel të përgjithshëm, janë regjistruar 13,123 biznese të reja, ndërsa janë shuar 1,349 biznese, duke rezultuar në një bilanc pozitiv prej 11,774 biznese. Të dhënat tregojnë se numri i bizneseve të reja është dukshëm më i madh se numri i bizneseve të shuara në të gjitha rajonet. Në nivel të përgjithshëm, bizneset e shuara përbëjnë 10.28% të bizneseve të reja. Pra, për çdo 100 biznese të reja të regjistruara gjatë vitit 2025, rreth 10 biznese janë shuar.

Rajoni Qendër ka numrin më të madh të bizneseve të reja, me 6,147, ndërsa janë shuar 453 biznese. Raporti i bizneseve të shuara ndaj bizneseve të reja është 7.37%, ndërsa sa i përket të gjitha bizneseve të shuara në shtatë rajonet përbën 33.58%.

Në Rajonin Veri janë regjistruar 1,291 biznese të reja, ndërsa janë shuar 222 biznese, qe rezulton me bilanc pozitiv prej 1,069 biznese. Raporti i bizneseve të shuara ndaj bizneseve të reja është 17.20%, që sipas tabelës është niveli më i lartë ndër shtatë rajonet. Ky rajon përben 16.46% të bizneseve të shuara në total.

Rajoni Perëndim ka regjistruar 944 biznese të reja dhe ka shuar 122 biznese, nga kjo del se 822 biznese jane aktive. Raporti i bizneseve të shuara ndaj bizneseve të reja është 12.92%. Bizneset e shuara të këtij rajoni përbëjnë 9.04% të totalit të bizneseve të shuara.

Në Rajonin Jug janë regjistruar 1,325 biznese të reja, ndërsa janë shuar 182 biznese, bilanci është pozitiv me 1,143 biznese aktive. Raporti i bizneseve të shuara ndaj bizneseve të reja është 13.74%. Rajoni Jug përfaqëson 13.49% të të gjitha bizneseve të shuara të shtatë rajoneve.

Rajoni Juglindje ka regjistruar 1,477 biznese të reja, ndërsa janë shuar vetëm 94 biznese, qe rezulton 1,383 biznese aktive. Raporti i bizneseve të shuara ndaj bizneseve të reja është 6.36%, niveli më i ulët ndër shtatë rajonet. Rajoni përbën 6.97% të bizneseve të shuara. Kjo tregon se në këtë rajon diferenca ndërmjet bizneseve të reja dhe atyre të shuara është relativisht e madhe.

Në Rajonin Lindje janë regjistruar 1,075 biznese të reja, ndërsa janë shuar 154 biznese. Bilanci është 921 biznese. Raporti i bizneseve të shuara ndaj të rejave është 14.33%. Rajoni përbën 11.42% të të gjitha bizneseve të shuara.

Në Rajonin Jugperëndim janë regjistruar 864 biznese të reja, ndërsa janë shuar 122 biznese. Bilanci është 742 biznese. Raporti i bizneseve të shuara ndaj të rejave është 14.12%. Rajoni përbën 9.04% të bizneseve të shuara.

Analiza e të dhënave për vitin 2025 tregon se në shtatë rajonet zhvillimore bilanci i regjistrimeve është pozitiv dhe arrin në 11,774 biznese. Raporti i bizneseve të shuara ndaj bizneseve të reja në nivel të përgjithshëm është 10.28%.


Rajoni Qendër paraqet numrin më të madh të bizneseve të reja dhe të bizneseve të shuara me 6,147 biznese të reja dhe 453 biznese të shuara. Megjithatë, raporti i bizneseve të shuara ndaj bizneseve të reja ne këtë rajon është vetëm 7.37%. Në anën tjetër, Rajoni Veri ka raportin më të lartë, me 17.20%, ndërsa Rajoni Juglindje ka raportin më të ulët, me 6.36%.Në të gjitha rajonet numri i bizneseve të reja është më i madh se numri i bizneseve të shuara, duke rezultuar me bilanc pozitiv të regjistrimeve. Kjo paraqet një tregues të rëndësishëm për dinamikën e krijimit dhe mbylljes së bizneseve gjatë vitit 2025.

TABELA 8 DHE GRAFIKONI: RAPORTI I BIZNESEVE TË REJA NDAJ BIZNESEVE TË SHUARA DHE % E SHUARJEVE TE BIZNESEVE NË SHTATË RAJONET ZHVILLIMORE


RAPORTI I BIZNESEVE TË REJA NDAJ BIZNESEVE TË SHUARA DHE % E SHUARJEVE TE BIZNESEVE NË SHTATË RAJONET ZHVILLIMORE

RAJONI	BIZNESE TË REJA 2025	BIZNESE TË SHUARA 2025	BILANCI	BIZNESET E SHUARA NDAJ TË REJAVE	% E SHUARJEVE TË BIZNESEVE NË 7 RAJONET
QENDËR	6,147	453	5,694	7.37%	33.58%
VERI	1,291	222	1,069	17.20%	16.46%
PERËNDIM	944	122	822	12.92%	9.04%
JUG	1,325	182	1,143	13.74%	13.49%
JUGLINDJE	1,477	94	1,383	6.36%	6.97%
LINDJE	1,075	154	921	14.33%	11.42%
JUGPERËNDIM	864	122	742	14.12%	9.04%
GJITHSEJ	**13,123**	**1,349**	**11,774**	**10.28%**	100.00%

PARAQITJA GRAFIKE E RAPORTIT TE BIZNESEVE TE SHUARA NDAJ BIZNESEVE TË REJAVE



PARAQITJA GRAFIKE E % SË BIZNESEVE TE SHUARA NË SHTATË RAJONET ZHVILLIMORE



NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA DHE TREGUESIT RELATIV TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS RAJONEVE

Tabela e mëposhtme paraqet gjendjen dhe dinamikën e zhvillimit të sektorit të bizneseve në shtatë rajonet zhvillimore të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2025. Analiza mbështetet në numrin e përgjithshëm të bizneseve të regjistruara deri më 31 dhjetor 2025, numrin e bizneseve të reja dhe të shuara gjatë vitit, si dhe në treguesit relativë që mundësojnë krahasimin e performancës së rajoneve, duke marrë parasysh edhe dallimet në madhësinë e popullsisë.

Sipas të dhënave të paraqitura, deri më 31.12.2025, në shtatë rajonet zhvillimore janë evidentuar gjithsej 226,465 biznese. Gjatë vitit 2025 janë regjistruar 13,123 biznese të reja, ndërsa janë shuar 1,349 biznese, duke rezultuar me rritje neto prej 11,774 biznese. Kjo dëshmon se numri i bizneseve të reja ka qenë dukshëm më i lartë se numri i bizneseve të shuara në të gjitha rajonet zhvillimore.

Normat e regjistrimit dhe shuarjes janë llogaritur në raport me numrin e përgjithshëm të bizneseve të regjistruara deri më 31.12.2025.

Rajoni Qendër ka numrin më të madh të bizneseve të regjistruara, me 92,288 biznese, si dhe numrin më të lartë të bizneseve të reja, me 6,147, që përbëjnë rreth 46.84% të regjistrimeve të reja në nivel të shtatë rajoneve. Ky rajon prin edhe për nga numri i bizneseve për 1,000 banorë, pra me 182 për 1000 banorë, si dhe për normën e regjistrimit të bizneseve të reja, me 6.66%. Këta tregues pasqyrojnë përqendrimin dhe dinamikën më të lartë të aktivitetit biznesor në këtë rajon.

Rajoni Juglindje paraqet rezultate pozitive në zhvillimin e bizneseve, me 1,477 biznese të reja dhe rritje neto prej 1,383 biznesesh. Ky rajon ka edhe normën më të ulët të shuarjes së bizneseve, me 0.37%, duke reflektuar bilanc pozitiv ndërmjet regjistrimeve të reja dhe shuarjeve te bizneseve.

Rajoni Veri karakterizohet nga normë relativisht e lartë e regjistrimit të bizneseve të reja, me 5.80%, por njëkohësisht ka normën më të lartë të shuarjes, me 1.00%. Ndërkaq, Rajoni Perëndim ka normën më të ulët të regjistrimit të bizneseve të reja, me 4.15%, ndërsa Rajoni Jugperëndim paraqet numrin më të ulët të bizneseve për 1,000 banorë, me 105, dhe numrin më të vogël të bizneseve të reja, me 864.


Në nivel të përgjithshëm, shtatë rajonet zhvillimore kanë mesatarisht 141 biznese për 1,000 banorë, normë të regjistrimit të bizneseve të reja prej 5.79% dhe normë të shuarjes prej 0.60%. Këta tregues evidentojnë dallimet në përqendrimin dhe dinamikën e aktivitetit biznesor ndërmjet rajoneve, si dhe rëndësinë e përdorimit të treguesve relativë për një vlerësim më të drejtë të performancës rajonale.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se aktiviteti biznesor është i shpërndarë në mënyrë jo të barabartë ndërmjet shtatë rajoneve zhvillimore, me përqendrim më të madh në Rajonin Qendër, ndërsa rajonet e tjera paraqesin nivele të ndryshme të zhvillimit dhe dinamikës së regjistrimit të bizneseve. Për këtë arsye, rekomandohet që politikat dhe masat mbështetëse të orientohen drejt nxitjes së ndërmarrësisë, mbështetjes së bizneseve të reja, rritjes së qëndrueshmërisë së tyre dhe krijimit të kushteve për zhvillim më të balancuar ekonomik në të gjitha rajonet zhvillimore.

TABELA 9 DHE GRAFIKONI: NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA DHE TREGUESIT RELATIV TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS RAJONEVE

TABELA E BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA, SI DHE TREGUESIT RELATIVË TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS SHTATË (7) RAJONEVE ZHVILLIMORE, VITI 2025

RAJONET	BIZNESE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	BIZNESE TE REJA 2025	BIZNESE TE SHUARA 2025	RRITJA E BIZNESEVE 2025	POPULLSIA E RAJONEVE	NUMRI I BIZNESEVE PËR 1000 BANOR	NORMA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE NË %	NORMA E SHUARJES SE BIZNESEVE NË %
RAJONI QENDËR	92,288	6,147	453	5,694	506,814	182	6.66%	0.49%
RAJONI VERI	22,270	1,291	222	1,069	190,591	117	5.80%	1.00%
RAJONI PERENDIM	22,756	944	122	822	174,031	131	4.15%	0.54%
RAJONI JUG	24,146	1,325	182	1,143	227,498	106	5.49%	0.75%
RAJONI JUGLINDJE	25,513	1,477	94	1,383	180,583	141	5.79%	0.37%
RAJONI LINDJE	21,759	1,075	154	921	154,669	141	4.94%	0.71%
RAJONI JUGPERENDIM	17,733	864	122	742	168,329	105	4.87%	0.69%
GJITHSEJ	**226,465**	**13,123**	**1,349**	**11,774**	**1,602,515**	**141**	**5.79%**	**0.60%**



BIZNESET E REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE DHE RAJONEVE ZHVILLIMORE

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelë, gjatë vitit 2025 janë regjistruar gjithsej 3,112 biznese të reja në sektorin e tregtisë në shtatë rajonet zhvillimore të Kosovës. Të dhënat tregojnë një përqendrim të konsiderueshëm të bizneseve të reja tregtare në Rajonin Qendër, ndërsa rajonet e tjera kanë pjesëmarrje më të shpërndarë.

Rajoni Qendër ka numrin më të madh të bizneseve të reja në tregti, me 1,388 biznese, që përbëjnë 44.60% të totalit. Kjo tregon një përqendrim të lartë të aktivitetit të ri tregtar në këtë rajon. Vetëm Prishtina ka regjistruar 887 biznese të reja tregtare, ndërsa Fushë Kosova 172, Podujeva 114 dhe Lipjani 77.

Rajoni Jug renditet pas Rajonit Qendër me 372 biznese të reja në tregti, ose rreth 11.95% të totalit. Prizreni dominon në këtë rajon me 289 biznese, ndërsa Suhareka ka 66.

Rajoni Veri ka regjistruar 363 biznese të reja tregtare, ose 11.66% të totalit. Mitrovica kryeson me 108, ndërsa Vushtrria me 93 dhe Mitrovica e Veriut me 53.

Rajoni Juglindje ka regjistruar 335 biznese, ose 10.76%. Ferizaj është qendra kryesore e aktivitetit tregtar me 259 biznese të reja, ndërsa Shtime dhe Kaçaniku kanë nga 31 biznese.

Rajoni Lindje ka 262 biznese të reja tregtare ose 8.42%, ku Gjilani kontribuon me 193, Vitia me 36 biznese dhe Kamenica me 27 biznese.

Rajoni Perëndim ka 209 biznese të reja ose 6.72%, Peja me 130 biznese, e ndjekur nga Istogu me 26, Klina me 29 dhe Deçani me 24 biznese.

Rajoni Jugperëndim ka numrin më të ulët, me 183 biznese të reja tregtare ose 5.88%. Gjakova ka 107, Rahoveci 44, Malisheva 26 dhe Juniku 6.

Nëse e krahasojmë te dhënat e numrit te bizneseve ne sektorin e tregtisë te regjistruar gjatë vitit 2025 që është 3,112 biznese me numrin total te bizneseve te regjistruara gjate vitit 2025 që është 13,123 biznese të reja në të gjitha aktivitetet, atëherë del se 23.71% e bizneseve te regjistruara gjate vitit 2025 i përkasin sektorit te tregtisë.

Në vitin 2025 shpërndarja rajonale tregon një përqendrim të theksuar në Rajonin Qendër, ku janë regjistruar 1,388 biznese ose 44.60% e totalit. Rajoni Jug përbën 11.95%, Rajoni Veri 11.66%, Rajoni Juglindje 10.76%, Rajoni Lindje 8.42%, Rajoni Perëndim 6.72%, ndërsa Rajoni Jugperëndim 5.88%.


Në nivel komunal, numri më i madh i regjistrimeve është evidentuar në Prishtinë me 887 biznese, Prizreni me 289, Ferizaj me 259, Gjilani me 193 dhe Fushë Kosova me 172. Këto të dhëna tregojnë përqendrim të aktivitetit të ri tregtar kryesisht në qendrat më të mëdha urbane dhe ekonomike.

Në përgjithësi, numri i bizneseve të reja tregon se sa aktiv është sektori i biznesit në secilin rajon. Duke e parë këtë tregues së bashku me punësimin, numrin e bizneseve, qarkullimin dhe importin e eksportin, mund të kuptohet më mirë gjendja dhe zhvillimi ekonomik i shtatë rajoneve zhvillimore.

TABELA 10 DHE GRAFIKONI: REGJISTRIMET E BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS RAJONEVE[10]

TABELA E REGJISTRIMEVE TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS RAJONEVE

RAJONET	BIZNESE TREGTARE – TË REJA	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË RAJONEVE
RAJONI QENDËR	1,388	45%
RAJONI VERI	363	12%
RAJONI PERENDIM	209	7%
RAJONI JUG	372	12%
RAJONI JUGLINDJE	335	11%
RAJONI LINDJE	262	8%
RAJONI JUGPERENDIM	183	6%
GJITHSEJ	**3,112**	100%



[10] Burimi: Agjencia e regjistrimit te bizneseve – ARBK, Data Open 16.09.2026.

Në vitin 2025 janë regjistruar gjithsej 65,488 punëkërkues. Struktura e tyre sipas nivelit të kualifikimit tregon se pjesën më të madhe e përbëjnë punëkërkuesit pa kualifikim, me 23,186 persona ose 35.40% të totalit. Kjo tregon një përqendrim të konsiderueshëm të punëkërkuesve në kategorinë me nivel më të ulët të kualifikimit.

Punëkërkuesit me arsim të mesëm profesional përbëjnë 15,499 persona ose 23.67%, ndërsa ata me arsim fillor (klasat I–IX) përbëjnë 13,856 persona ose 21.16%. Këto dy kategori së bashku përfaqësojnë 44.83% të gjithë punëkërkuesve të regjistruar.


Ndërkohë, 5,721 punëkërkues, ose 8.74%, kanë përfunduar shkollën e mesme – gjimnaz. Punëkërkuesit me nivel Bachelor përbëjnë 6,535 persona ose 9.98%, ndërsa ata me nivel Master vetëm 691 persona ose 1.06%.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se mbi katër të pestat (88.97%) e punëkërkuesve të regjistruar janë: pa kualifikuar, shkolla fillore, arsimi i mesëm profesional, shkolle e mesme dhe gjimnaz, ndërsa vetëm rreth 11.03% kanë përfunduar studimet universitare në nivelin Bachelor ose Master.

Kjo tregon se është e nevojshme të ofrohen më shumë mundësi për arsim profesional dhe trajnime, në mënyrë që punëkërkuesit me nivel më të ulët arsimor të fitojnë njohuri dhe aftësi praktike që kërkohen nga tregu i punës dhe të kenë më shumë mundësi për t'u punësuar.

TABELA 11 DHE GRAFIKONI: STRUKTURA E PUNËKËRKUESVE TË REGJISTRUAR SIPAS KUALIFIKIMIT NË VITIN 2025

STRUKTURA E PUNËKËRKUESVE TË REGJISTRUAR SIPAS KUALIFIKIMIT NË VITIN 2025		
NIVELI I KUALIFIKIMEVE	**2025**	
	NUMËR	**%**
PA KUALIFIKUAR	23,186	35.40%
KLASËT I-IX (SHKOLLA FILLORE)	13,856	21.16%
ARSIMI I MESËM PROFESIONAL	15,499	23.67%
SHKOLLË E MESME GJIMNAZ	5,721	8.74%
BACHELOR	6,535	9.98%
MASTER	691	1.06%
DR. SHKENCE	-	
GJITHSEJ	**65,488**	**100%**



Analiza e strukturës së punëkërkuesve sipas grupmoshës tregon se pjesën më të madhe e përbëjnë personat e moshës 25–39 vjeç, me 26,667 persona ose 40.72% të totalit.

Grupmosha 40–54 vjeç renditet e dyta, me 20,367 punëkërkues ose 31.10%. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e punëkërkuesve i përket moshës së mesme, e cila përfaqëson një potencial të rëndësishëm për tregun e punës, duke pasur parasysh përvojën dhe aftësitë profesionale që mund të kenë këta persona.


Ndërkohë, grupmosha 15–24 vjeç përfshin 10,371 persona ose 15.84% të punëkërkuesve të regjistruar. Kjo kategori përfaqëson të rinjtë që hyjnë në tregun e punës dhe për të cilët janë të rëndësishme orientimi profesional, aftësimi dhe krijimi i mundësive për punësim.

Grupmosha 55 vjeç e lart përfshin 8,083 punëkërkues, që përbëjnë 12.34% të numrit të përgjithshëm. Për këtë kategori, është e rëndësishme të krijohen mundësi të përshtatshme punësimi dhe të ofrohen trajnime për përditësimin e njohurive dhe aftësive profesionale, me qëllim lehtësimin e përfshirjes dhe rikthimit të tyre në tregun e punës.

Struktura e punëkërkuesve sipas grupmoshës tregon se 71.82% e tyre janë të moshës 25–54 vjeç, duke dëshmuar se pjesa më e madhe e personave të regjistruar si punëkërkues i përket grupmoshave në moshë aktive pune. Kjo nënvizon rëndësinë e politikave aktive të tregut të punës, programeve të aftësimit profesional dhe masave për lehtësimin e përputhjes së aftësive të punëkërkuesve me kërkesat e punëdhënësve.

TABELA 12 DHE GRAFIKONI: PUNËKËRKUESIT E REGJISTRUAR SIPAS GRUPMOSHËS NË VITIN 2025

PUNËKËRKUESIT E REGJISTRUAR SIPAS GRUPMOSHËS NË VITIN 2025		
GRUPMOSHA	**2025**	
	NUMËR	**%**
15 - 24	10,371	15.84%
25 - 39	26,667	40.72%
40 - 54	20,367	31.10%
55+	8,083	12.34%
GJITHSEJ	**65,488**	**100%**



IMPORTI DHE EKSPORTI I MALLRAVE 2025

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), gjatë vitit 2025, vlera e përgjithshme e eksportit të mallrave të Kosovës arriti në 942,1 milionë euro, ndërsa importi arriti në 7,06 miliardë euro. Si rezultat, bilanci tregtar shënoi deficit prej 6,11 miliardë euro, duke reflektuar diferencën e konsiderueshme ndërmjet vlerës së mallrave të eksportuara dhe atyre të importuara.


Importi ishte rreth 7,5 herë më i lartë se eksporti, ndërsa eksporti mbuloi vetëm 13,35% të vlerës së importit. Kjo tregon se një pjesë e madhe e kërkesës së brendshme për mallra plotësohet përmes tregjeve të jashtme, ndërsa eksportet vendore kanë peshë dukshëm më të ulët në raport me importet.

Deficiti i lartë tregtar paraqet një sfidë të rëndësishme për ekonominë e Kosovës dhe thekson nevojën për forcimin e kapaciteteve prodhuese vendore, rritjen e nivelit të përpunimit të produkteve dhe zgjerimin e bazës eksportuese. Në këtë drejtim, mbështetja e ndërmarrjeve vendore përmes investimeve në teknologji dhe inovacion, përmirësimit të cilësisë dhe standardeve të produkteve, si dhe lehtësimit të qasjes në tregjet ndërkombëtare, është e rëndësishme për rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë vendore dhe përmirësimin e bilancit tregtar të Kosovës.

Në përfundim, të dhënat për vitin 2025 tregojnë se tregtia e jashtme e Kosovës karakterizohet nga një deficit i konsiderueshëm tregtar. Përmirësimi i këtij bilanci kërkon masa të qëndrueshme për zhvillimin e prodhimit vendor, diversifikimin e produkteve të eksportuara dhe rritjen e aftësisë së ndërmarrjeve për të konkurruar në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.

TABELA 13 DHE GRAFIKONI: VLERA E IMPORTIT DHE EKSPORTIT

VLERA E IMPORTIT DHE EKSPORTIT				
VITI	**EKSPORT (mijë euro)**	**IMPORT (mijë euro)**	**BILANCI TREGTAR (mijë euro)**	**MBULIMI I EKSPORTIT NGA IMPORTI**
2025	942,137	7,055,838	(6,113,701)	**13.35%**



PËRFUNDIME

Bazuar në të dhënat e analizuara për tregtinë dhe bizneset gjatë vitit 2025, mund të nxirren këto përfundime kryesore:

- ✓ Aktiviteti biznesor ka shënuar rritje të konsiderueshme, me gjithsej 13,123 biznese të reja të regjistruara gjatë vitit 2025;
- ✓ Tregtia përbën sektorin me pjesëmarrjen më të madhe në regjistrimet e reja, me 3,112 biznese ose 23.71% të totalit. Pas saj renditen industria përpunuese, ndërtimtaria dhe aktivitetet profesionale, shkencore e teknike;
- ✓ Pjesën më të madhe te bizneseve të reja në sektorin e tregtisë e përbëjnë bizneset në Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe komunat tjera me aktivitet më të zhvilluar ekonomik;
- ✓ Regjistrimet e reja janë të përqendruara në disa sektorë kryesorë ekonomikë. Pesë sektorët me numrin më të madh të regjistrimeve përbëjnë rreth 65% të gjitha bizneseve të reja;
- ✓ Rajoni Qendër ka pozitën dominuese në aktivitetin e ri biznesor, veçanërisht në sektorin e tregtisë, ndërsa rajonet tjera kanë pjesëmarrje më të ulët. Kjo tregon për një përqendrim të aktivitetit ekonomik në rajonet dhe qendrat urbane më të mëdha;
- ✓ Raporti ndërmjet bizneseve të reja dhe bizneseve të shuara paraqet bilanc pozitiv, me 13,123 biznese të reja dhe 1,349 biznese të shuara, duke rezultuar me bilanc prej 11,774 biznese;
- ✓ Nga aspekti i formës juridike, SH.P.K. përbën formën dominuese të bizneseve të regjistruara, me 74.4%, ndërsa bizneset individuale përbëjnë 25.1%;
- ✓ Regjistrimet mujore tregojnë një aktivitet relativisht të qëndrueshëm gjatë vitit, me numrin më të madh të regjistrimeve në maj me 1,333 biznese dhe numrin më të ulët në nëntor me 919 biznese.
- ✓ Struktura e punëkërkuesve tregon nevojën për përshtatje më të mirë të aftësive të fuqisë punëtore me kërkesat e tregut, veçanërisht përmes arsimit profesional, aftësimit dhe riaftësimit.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë se tregtia dhe bizneset kanë rol të rëndësishëm në aktivitetin ekonomik dhe në krijimin e mundësive për punësim, por ekziston nevoja për diversifikim më të madh të aktiviteteve ekonomike dhe zhvillim më të balancuar ndërmjet rajoneve.

REKOMANDIME

- Rekomandohet që gjetjet e kësaj analize të shfrytëzohen gjatë hartimit dhe zbatimit të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe për Bujqësi, duke shqyrtuar mundësinë e përfshirjes së kritereve stimuluese dhe pikëve shtesë për aplikuesit nga komunat me nivel më të ulët të aktivitetit biznesor. Vëmendje e veçantë mund t'u kushtohet komunave si Parteshi, Ranillugu, Kllokoti, Novobërda, Juniku, Shtërpca, Mamusha dhe Dragashi, me qëllim nxitjen e ndërmarrësisë, investimeve dhe zhvillimit ekonomik;
- Treguesit kryesorë të kësaj analize, si numri i bizneseve për 1,000 banorë, norma e regjistrimit dhe norma e shuarjes së bizneseve, të përfshihen në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Strategjisë për Zhvillim Rajonal. Këta tregues do të mundësojnë përcjelljen e ndryshimeve në aktivitetin biznesor dhe identifikimin e rajoneve dhe komunave që kanë nevojë për ndërhyrje dhe mbështetje më të madhe.
- Qendrat për Zhvillim Rajonal të shfrytëzojnë rezultatet e analizës në identifikimin e nevojave dhe potencialeve ekonomike të komunave, në promovimin e mundësive për investime dhe në mbështetjen e ndërmarrësisë në nivel lokal. Gjithashtu, ato mund të kontribuojnë në monitorimin e zhvillimit të bizneseve dhe identifikimin e pengesave me të cilat përballen ndërmarrjet në rajonet përkatëse;
- Duke marrë parasysh se Rajoni Veri paraqet normën më të lartë të shuarjes së bizneseve, prej 1.00%, rekomandohet realizimi i një analize të veçantë për identifikimin e faktorëve ekonomikë, administrativë dhe institucionalë që ndikojnë në këtë dukuri.
- Ministritë relevante në bashkëpunim me komunat dhe institucionet përkatëse, të identifikojë nevojat për mbështetje të bizneseve të reja, veçanërisht në komunat me numër të ulët të bizneseve për 1,000 banorë. Masat mund të përfshijnë mbështetje për investime, zhvillim të kapaciteteve, këshillim për ndërmarrësit dhe promovim të mundësive për krijimin e bizneseve të reja;
- Fuqizimi i mbështetjes për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe bizneset e reja, përmes instrumenteve të financimit, këshillimit dhe programeve të zhvillimit, me fokus në rritjen e kapaciteteve, produktivitetit dhe qëndrueshmërisë së tyre.
- Të nxitet diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në rajone, me fokus në sektorët prodhues, industrinë përpunuese, bujqësinë, teknologjinë dhe sektorët e tjerë me potencial zhvillimor. Njëkohësisht, të mbështetet rritja e konkurrueshmërisë së bizneseve vendore, zhvillimi i inovacionit dhe digjitalizimit, si dhe përmirësimi i qasjes së tyre në tregjet e jashtme.
- Përmirësimi i aftësive profesionale të fuqisë punëtore përmes programeve të aftësimit dhe trajnimit profesional, në përputhje me nevojat e bizneseve dhe kërkesat e tregut të punës.
- Monitorimi i bizneseve të reja dhe identifikimi i bizneseve të shuara, me qëllim identifikimin e trendeve, faktorëve që ndikojnë në krijimin dhe mbylljen e bizneseve, si dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë së tyre në nivel komunal (rajonal).

Në përgjithësi, rekomandohet që politikat dhe masat për zhvillimin e sektorit të biznesit të mos fokusohen vetëm në rritjen e numrit të bizneseve të reja, por edhe në përmirësimin e qëndrueshmërisë së tyre, rritjen e punësimit, prodhimit, produktivitetit dhe eksporteve. Kjo do të kontribuojë në zvogëlimin e dallimeve ndërmjet rajoneve dhe në avancimin e zhvillimit të balancuar të shtatë rajoneve zhvillimore.

SHTOJCAT:

SHTOJCA1: NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA DERI ME DATËN 31.12.2025

TABELA ME NUMRIN DHE % E BIZNESEVE TE REGJISTRUARA SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT QENDËR DERI ME 31.12.2025

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I BIZNESEVE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	% E BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE
RAJONI QENDËR	1	PRISHTINË	62,328	27.52
	2	GLLOGOVC	4,841	2.14
	3	FUSHË KOSOVË	7,668	3.39
	4	GRAÇANICË	2,030	0.90
	5	LIPJAN	6,222	2.75
	6	OBILIQ	2,246	0.99
	7	PODUJEVË	6,953	3.07
		GJITHSEJ	**92,288**	**40.75**




TABELA ME NUMRIN DHE % E BIZNESEVE TE REGJISTRUARA SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT VERI DERI ME 31.12.2025

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I BIZNESEVE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	% E BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE
RAJONI VERI	1	MITROVICË	8,846	3.91
	2	SKENDERAJ	3,336	1.47
	3	VUSHTRRI	5,851	2.58
	4	MITROVICA E VERIUT	1,069	0.47
	5	LEPOSAVIQ	1,569	0.69
	6	ZVEQAN	885	0.39
	7	ZUBIN POTOK	714	0.32
		GJITHSEJ	**22,270**	**9.83**




TABELA ME NUMRIN DHE % E BIZNESEVE TE REGJISTRUARA SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT PERËNDIM DERI ME 31.12.2025

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I BIZNESEVE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	% E BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE
RAJONI PERËNDIM	1	PEJË	12,678	5.60
	2	ISTOG	3,768	1.66
	3	DEÇAN	2,866	1.27
	4	KLINË	3,444	1.52
		GJITHSEJ	**22,756**	**10.05**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT DHE % SE BIZNESEVE TË REGJISTRUARA NË RAJONIN PERENDIM DERI ME 31.12.2025




TABELA ME NUMRIN DHE % E BIZNESEVE TE REGJISTRUARA SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUG DERI ME 31.12.2025

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I BIZNESEVE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	% E BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE
RAJONI JUG	1	PRIZREN	18,112	8.00
	2	DRAGASH	1,469	0.65
	3	MAMUSHË	296	0.13
	4	SUHAREKË	4,269	1.88
		GJITHSEJ	**24,146**	**10.66**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT DHE % SE BIZNESEVE TË REGJISTRUARA NË RAJONIN JUG DERI ME 31.12.2025




TABELA ME NUMRIN DHE % E BIZNESEVE TE REGJISTRUARA SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUGLINDJE DERI ME 31.12.2025

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I BIZNESEVE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	% E BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE
RAJONI JUGLINDJE	1	FERIZAJ	18,189	8.03
	2	SHTIME	2,460	1.09
	3	KAÇANIK	3,470	1.53
	4	SHTËRPCË	904	0.40
	5	HANI I ELEZIT	490	0.22
		GJITHSEJ	**25,513**	**11.26**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT DHE % SE BIZNESEVE TË REGJISTRUARA NË RAJONIN JUGLINDJE DERI ME 31.12.2025




TABELA ME NUMRIN DHE % E BIZNESEVE TE REGJISTRUARA SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT LINDJE DERI ME 31.12.2025

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I BIZNESEVE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	% E BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE
RAJONI LINDJE	1	GJILAN	13,276	5.86
	2	VITI	4,716	2.08
	3	NOVOBËRDË	464	0.20
	4	KAMENICË	3,121	1.38
	5	KLLOKOT	81	0.04
	6	RANILLUGË	56	0.02
	7	PARTESH	45	0.02
		GJITHSEJ	**21,759**	**9.61**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT DHE % SE BIZNESEVE TË REGJISTRUARA NË RAJONIN LINDJE DERI ME 31.12.2025





TABELA ME NUMRIN DHE % E BIZNESEVE TE REGJISTRUARA SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUGPERENDIM DERI ME 31.12.2025

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I BIZNESEVE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	% E BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE
RAJONI JUGPERENDIM	1	GJAKOVË	10,213	4.51
	2	MALISHEVË	3,395	1.50
	3	RAHOVEC	4,007	1.77
	4	JUNIK	118	0.05
	GJITHSEJ		**17,733**	**7.83**



SHTOJCA2: NUMRI I BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025

TABELA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT QENDËR

RAJONET	NR.	KOMUNAT	REGJISTRIME TE BIZNESEVE TË REJA 2025	PUNËTORË – REGJISTRIME 2025
RAJONI QENDËR	1	PRISHTINË	4,222	8,199
	2	GLLOGOVC	260	400
	3	FUSHË KOSOVË	669	986
	4	GRAÇANICË	133	319
	5	LIPJAN	325	468
	6	OBILIQ	117	168
	7	PODUJEVË	421	679
	GJITHSEJ		**6,147**	**11,219**




TABELA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT VERI

RAJONET	NR.	KOMUNAT	REGJISTRIME TE BIZNESEVE TË REJA 2025	PUNËTORË – REGJISTRIME 2025
RAJONI VERI	1	MITROVICË	453	617
	2	SKENDERAJ	173	264
	3	VUSHTRRI	304	401
	4	MITROVICA E VERIUT	180	230
	5	LEPOSAVIQ	90	114
	6	ZVEQAN	47	61
	7	ZUBIN POTOK	44	53
	GJITHSEJ		**1,291**	**1,740**



TABELA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT PERËNDIM

RAJONET	NR.	KOMUNAT	REGJISTRIME TE BIZNESEVE TË REJA 2025	PUNËTORË – REGJISTRIME 2025
RAJONI PERENDIM	1	PEJË	543	956
	2	ISTOG	157	259
	3	DEÇAN	103	147
	4	KLINË	141	251
	GJITHSEJ		**944**	**1,613**




TABELA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT JUG

RAJONET	NR.	KOMUNAT	REGJISTRIME TE BIZNESEVE TË REJA 2025	PUNËTORË – REGJISTRIME 2025
RAJONI JUG	1	PRIZREN	944	1,418
	2	DRAGASH	47	65
	3	MAMUSHË	39	53
	4	SUHAREKË	295	394
	GJITHSEJ		**1,325**	**1,930**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 NË RAJONIN JUG




TABELA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT JUGLINDJE

RAJONET	NR.	KOMUNAT	REGJISTRIME TE BIZNESEVE TË REJA 2025	PUNËTORË – REGJISTRIME 2025
RAJONI JUGLINDJE	1	FERIZAJ	1,133	1,928
	2	SHTIME	126	237
	3	KAÇANIK	151	200
	4	SHTËRPCË	21	21
	5	HANI I ELEZIT	46	77
	GJITHSEJ		**1,477**	**2,463**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 NË RAJONIN JUGLINDJE




TABELA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT LINDJE

RAJONET	NR.	KOMUNAT	REGJISTRIME TE BIZNESEVE TË REJA 2025	PUNËTORË – REGJISTRIME 2025
RAJONI LINDJE	1	GJILAN	733	1,292
	2	VITI	183	325
	3	NOVOBËRDË	17	18
	4	KAMENICË	123	191
	5	KLLOKOT	10	11
	6	RANILLUGË	7	15
	7	PARTESH	2	2
		GJITHSEJ	**1,075**	**1,854**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 NË RAJONIN LINDJE




TABELA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT JUGPERËNDIM

RAJONET	NR.	KOMUNAT	REGJISTRIME TE BIZNESEVE TË REJA 2025	PUNËTORË – REGJISTRIME 2025
RAJONI JUGPERENDIM	1	GJAKOVË	476	757
	2	MALISHEVË	196	340
	3	RAHOVEC	174	259
	4	JUNIK	18	24
		GJITHSEJ	**864**	**1,380**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TË REJA DHE I PUNËTORVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 NË RAJONIN JUGPERENDIM



SHTOJCA 3: NUMRI I NDËRMARRJEVE TE MESME DHE TE VOGLA DHE I PUNËTORËVE TË RI TË REGJISTRUAR GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE NË RAJONET ZHVILLIMORE

TABELA E REGJISTRIMEVE TË NVM TE REJA SI DHE NUMRI I REGJISTRIMIT TË PUNËTORËVE GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT QENDËR

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I NVM-ve TË REJA	PUNËTORË NË NVM TË REJA
RAJONI QENDËR	1	PRISHTINË	4,218	7,199
	2	GLLOGOVC	256	400
	3	FUSHË KOSOVË	667	986
	4	GRAÇANICË	133	319
	5	LIPJAN	321	468
	6	OBILIQ	117	168
	7	PODUJEVË	420	679
	GJITHSEJ		**6,132**	**10,219**




TABELA E REGJISTRIMEVE TË NVM TE REJA SI DHE NUMRI I REGJISTRIMIT TË PUNËTORËVE GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT VERI

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I NVM-ve TË REJA	PUNËTORË NË NVM TË REJA
RAJONI VERI	1	MITROVICË	451	617
	2	SKENDERAJ	172	264
	3	VUSHTRRI	304	401
	4	MITROVICA E VERIUT	179	230
	5	LEPOSAVIQ	90	114
	6	ZVEQAN	47	61
	7	ZUBIN POTOK	44	53
	GJITHSEJ		**1,287**	**1,740**




TABELA E REGJISTRIMEVE TË NVM TE REJA SI DHE NUMRI I REGJISTRIMIT TË PUNËTORËVE GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT PERËNDIM

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I NVM-ve TË REJA	PUNËTORË NË NVM TË REJA
RAJONI PERENDIM	1	PEJË	543	956
	2	ISTOG	155	259
	3	DEÇAN	103	147
	4	KLINË	140	251
	GJITHSEJ		**941**	**1,613**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE REGJISTRIMEVE TË NVM TË REJA SI DHE NUMRI I REGJISTRIMIT TË PUNËTORËVE GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT PERËNDIM




TABELA E REGJISTRIMEVE TË NVM TE REJA SI DHE NUMRI I REGJISTRIMIT TË PUNËTORËVE GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT JUG

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I NVM-ve TË REJA	PUNËTORË NË NVM TË REJA
RAJONI JUG	1	PRIZREN	940	1,418
	2	DRAGASH	47	65
	3	MAMUSHË	39	53
	4	SUHAREKË	295	394
	GJITHSEJ		**1,321**	**1,930**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE REGJISTRIMEVE TË NVM TË REJA SI DHE NUMRI I REGJISTRIMIT TË PUNËTORËVE GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUG




TABELA E REGJISTRIMEVE TË NVM TE REJA SI DHE NUMRI I REGJISTRIMIT TË PUNËTORËVE GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT JUGLINDJE

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I NVM-ve TË REJA	PUNËTORË NË NVM TË REJA
RAJONI JUGLINDJE	1	FERIZAJ	1,132	1,928
	2	SHTIME	125	237
	3	KAÇANIK	151	200
	4	SHTËRPCË	21	21
	5	HANI I ELEZIT	45	77
		GJITHSEJ	**1,474**	**2,463**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE REGJISTRIMEVE TË NVM TË REJA SI DHE NUMRI I REGJISTRIMIT TË PUNËTORËVE GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUGLINDJE




TABELA E REGJISTRIMEVE TË NVM TE REJA SI DHE NUMRI I REGJISTRIMIT TË PUNËTORËVE GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT LINDJE

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I NVM-ve TË REJA	PUNËTORË NË NVM TË REJA
RAJONI LINDJE	1	GJILAN	730	1,292
	2	VITI	183	325
	3	NOVOBËRDË	17	18
	4	KAMENICË	122	191
	5	KLLOKOT	10	11
	6	RANILLUGË	7	15
	7	PARTESH	2	2
		GJITHSEJ	**1,071**	**1,854**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE REGJISTRIMEVE TË NVM TË REJA SI DHE NUMRI I REGJISTRIMIT TË PUNËTORËVE GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT LINDJE





TABELA E REGJISTRIMEVE TË NVM TE REJA SI DHE NUMRI I REGJISTRIMIT TË PUNËTOREVE GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT JUGPERËNDIM

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I NVM-ve TË REJA	PUNËTORË NË NVM TË REJA
RAJONI JUGPERENDIM	1	GJAKOVË	473	757
	2	MALISHEVË	196	340
	3	RAHOVEC	173	259
	4	JUNIK	17	24
	GJITHSEJ		**859**	**1,380**



SHTOJCA 4: NUMRI I BIZNESEVE TË SHUARA GJATË VITIT 2025

TABELA ME NUMRIN E BIZNESEVE TE SHUARA SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT QENDËR GJATË VITIT 2025

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I BIZNESEVE TË SHUARA 2025	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË KOMUNAVE TË RAJONIT
RAJONI QENDËR	1	PRISHTINË	248	55%
	2	GLLOGOVC	46	10%
	3	FUSHË KOSOVË	32	7%
	4	GRAÇANICË	27	6%
	5	LIPJAN	34	8%
	6	OBILIQ	14	3%
	7	PODUJEVË	52	11%
GJITHSEJ			**453**	**100%**




TABELA ME NUMRIN E BIZNESEVE TE SHUARA SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT VERI GJATË VITIT 2025

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I BIZNESEVE TË SHUARA 2025	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË KOMUNAVE TË RAJONIT
RAJONI VERI	1	MITROVICË	92	41%
	2	SKENDERAJ	35	16%
	3	VUSHTRRI	62	28%
	4	MITROVICA E VERIUT	11	5%
	5	LEPOSAVIQ	12	5%
	6	ZVEQAN	8	4%
	7	ZUBIN POTOK	2	1%
GJITHSEJ			**222**	**100%**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TE SHUARA GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT VERI




TABELA ME NUMRIN E BIZNESEVE TE SHUARA SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT PERENDIM GJATË VITIT 2025

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I BIZNESEVE TË SHUARA 2025	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË KOMUNAVE TË RAJONIT
RAJONI PERENDIM	1	PEJË	63	52%
	2	ISTOG	17	14%
	3	DEÇAN	17	14%
	4	KLINË	25	20%
GJITHSEJ			**122**	**100%**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TE SHUARA GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT PERËNDIM




TABELA ME NUMRIN E BIZNESEVE TE SHUARA SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUG GJATË VITIT 2025

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I BIZNESEVE TË SHUARA 2025	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË KOMUNAVE TË RAJONIT
RAJONI JUG	1	PRIZREN	108	59%
	2	DRAGASH	17	9%
	3	MAMUSHË	1	1%
	4	SUHAREKË	56	31%
GJITHSEJ			**182**	**100%**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TE SHUARA GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUG




TABELA ME NUMRIN E BIZNESEVE TE SHUARA SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUGLINDJE GJATË VITIT 2025

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I BIZNESEVE TË SHUARA 2025	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË KOMUNAVE TË RAJONIT
RAJONI JUGLINDJE	1	FERIZAJ	63	67%
	2	SHTIME	9	10%
	3	KAÇANIK	9	10%
	4	SHTËRPCË	7	7%
	5	HANI I ELEZIT	6	6%
GJITHSEJ			**94**	**100%**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TE SHUARA GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUGLINDJE



TABELA ME NUMRIN E BIZNESEVE TE SHUARA SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT LINDJE GJATË VITIT 2025

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I BIZNESEVE TË SHUARA 2025	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË KOMUNAVE TË RAJONIT
RAJONI LINDJE	1	GJILAN	95	62%
	2	VITI	28	18%
	3	NOVOBËRDË	1	1%
	4	KAMENICË	25	16%
	5	KLLOKOT	3	2%
	6	RANILLUGË	2	1%
	7	PARTESH	-	0%
GJITHSEJ			**154**	**100%**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TE SHUARA GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT LINDJE





TABELA ME NUMRIN E BIZNESEVE TE SHUARA SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUGPERENDIM GJATË VITIT 2025

RAJONET	NR.	KOMUNAT	NUMRI I BIZNESEVE TË SHUARA 2025	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË KOMUNAVE TË RAJONIT
RAJONI JUGPERENDIM	1	GJAKOVË	73	60%
	2	MALISHEVË	27	22%
	3	RAHOVEC	21	17%
	4	JUNIK	1	1%
GJITHSEJ			**122**	**100%**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TE SHUARA GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUGPERËNDIM




SHTOJCA 5: NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA, SI DHE TREGUESIT RELATIV TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE, VITI 2025

NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA DHE TREGUESIT RELATIV TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT QENDËR


RAJONET	Nr.	KOMUNAT	BIZNESE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	BIZNESE TE REJA	BIZNESE TE SHUARA	BIZNESE 2025	POPULLËSIA E KOSOVËS	BIZNESE PËR 1000 BANOR	NORMA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE NË %	NORMA E SHUARJES SE BIZNESEVE NË %
RAJONI QENDËR	1	PRISHTINË	62,328	4,222	248	3,974	227,466	274	6.77%	0.40%
	2	GLLOGOVC	4,841	260	46	214	48,079	101	5.37%	0.95%
	3	FUSHË KOSOVË	7,668	669	32	637	63,949	120	8.72%	0.42%
	4	GRAÇANICË	2,030	133	27	106	18,486	110	6.55%	1.33%
	5	LIPJAN	6,222	325	34	291	55,044	113	5.22%	0.55%
	6	OBILIQ	2,246	117	14	103	22,815	98	5.21%	0.62%
	7	PODUJEVË	6,953	421	52	369	70,975	98	6.05%	0.75%
GJITHSEJ			**92,288**	**6,147**	**453**	**5,694**	**506,814**	**914**		

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TË BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA, DHE TREGUESIT RELATIVË TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT QENDËR




NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA DHE TREGUESIT RELATIV TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT VERI

RAJONET	Nr.	KOMUNAT	BIZNESE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	BIZNESE TE REJA	BIZNESE TE SHUARA	BIZNESE 2025	POPULLËSIA E KOSOVËS	BIZNESE PËR 1000 BANOR	NORMA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE NË %	NORMA E SHUARJES SE BIZNESEVE NË %
RAJONI VERI	1	MITROVICË	8,846	453	92	361	64,742	137	5.12%	1.04%
	2	SKENDERAJ	3,336	173	35	138	40,664	82	5.19%	1.05%
	3	VUSHTRRI	5,851	304	62	242	61,528	95	5.20%	1.06%
	4	MITROVICA E VERIUT	1,069	180	11	169	7,920	135	16.84%	1.03%
	5	LEPOSAVIQ	1,569	90	12	78	9,485	165	5.74%	0.76%
	6	ZVEQAN	885	47	8	39	2,867	309	5.31%	0.90%
	7	ZUBIN POTOK	714	44	2	42	3,385	211	6.16%	0.28%
GJITHSEJ			**22,270**	**1,291**	**222**	**1,069**	**190,591**	**1,134**		



NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA DHE TREGUESIT RELATIV TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT PERËNDIM


RAJONET	Nr.	KOMUNAT	BIZNESE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	BIZNESE TE REJA	BIZNESE TE SHUARA	BIZNESE 2025	POPULLËSIA E KOSOVËS	BIZNESE PËR 1000 BANOR	NORMA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE NË %	NORMA E SHUARJES SE BIZNESEVE NË %
RAJONI PERËNDIM	1	PEJË	12,678	543	63	480	82,745	153.22	4.28%	0.50%
	2	ISTOG	3,768	157	17	140	33,008	114.15	4.17%	0.45%
	3	DEÇAN	2,866	103	17	86	27,775	103.19	3.59%	0.59%
	4	KLINË	3,444	141	25	116	30,503	112.91	4.09%	0.73%
GJITHSEJ			**22,756**	**944**	**122**	**822**	**174,031**	**483**		



NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA DHE TREGUESIT RELATIV TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT JUG


RAJONET	Nr.	KOMUNAT	BIZNESE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	BIZNESE TE REJA	BIZNESE TE SHUARA	BIZNESE 2025	POPULLËSIA E KOSOVËS	BIZNESE PËR 1000 BANOR	NORMA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE NË %	NORMA E SHUARJES SE BIZNESEVE NË %
RAJONI JUG	1	PRIZREN	18,112	944	108	836	147,246	123	5.21%	0.60%
	2	DRAGASH	1,469	47	17	30	28,896	51	3.20%	1.16%
	3	MAMUSHË	296	39	1	38	5,607	53	13.18%	0.34%
	4	SUHAREKË	4,269	295	56	239	45,749	93	6.91%	1.31%
GJITHSEJ			**24,146**	**1,325**	**182**	**1,143**	**227,498**	**320**		

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TË BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA, DHE TREGUESIT RELATIVË TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUG




NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA DHE TREGUESIT RELATIV TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT JUGLINDJE

RAJONET	Nr.	KOMUNAT	BIZNESE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	BIZNESE TE REJA	BIZNESE TE SHUARA	BIZNESE 2025	POPULLËSIA E KOSOVËS	BIZNESE PËR 1000 BANOR	NORMA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE NË %	NORMA E SHUARJES SE BIZNESEVE NË %
RAJONI JUGLINDJE	1	FERIZAJ	18,189	1,133	63	1,070	109,255	166	6.23%	0.35%
	2	SHTIME	2,460	126	9	117	24,308	101	5.12%	0.37%
	3	KAÇANIK	3,470	151	9	142	27,716	125	4.35%	0.26%
	4	SHTËRPCË	904	21	7	14	10,771	84	2.32%	0.77%
	5	HANI I ELEZIT	490	46	6	40	8,533	57	9.39%	1.22%
	6	FERIZAJ	18,189	1,133	63	1,070	109,255	166	6.23%	0.35%
	7	SHTIME	2,460	126	9	117	24,308	101	5.12%	0.37%
GJITHSEJ			**25,513**	**1,477**	**94**	**1,383**	**180,583**	**534**		



NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA DHE TREGUESIT RELATIV TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT LINDJE


RAJONET	Nr.	KOMUNAT	BIZNESE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	BIZNESE TE REJA	BIZNESE TE SHUARA	BIZNESE 2025	POPULLËSIA E KOSOVËS	BIZNESE PËR 1000 BANOR	NORMA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE NË %	NORMA E SHUARJES SE BIZNESEVE NË %
RAJONI LINDJE	1	GJILAN	13,276	733	95	638	82,980	160	5.52%	0.72%
	2	VITI	4,716	183	28	155	35,566	133	3.88%	0.59%
	3	NOVOBËRDË	464	17	1	16	4,493	103	3.66%	0.22%
	4	KAMENICË	3,121	123	25	98	22,868	136	3.94%	0.80%
	5	KLLOKOT	81	10	3	7	3,041	27	12.35%	3.70%
	6	RANILLUGË	56	7	2	5	2,481	23	12.50%	3.57%
	7	PARTESH	45	2	-	2	3,240	14	4.44%	0.00%
GJITHSEJ			**21,759**	**1,075**	**154**	**921**	**154,669**	**595**		



NUMRI I BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA DHE TREGUESIT RELATIV TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE TË RAJONIT JUGPERËNDIM

RAJONET	Nr.	KOMUNAT	BIZNESE TE REGJISTRUARA DERI ME 31.12.2025	BIZNESE TE REJA	BIZNESE TE SHUARA	BIZNESE 2025	POPULLËSIA E KOSOVËS	BIZNESE PËR 1000 BANOR	NORMA E REGJISTRIMIT TE BIZNESEVE NË %	NORMA E SHUARJES SE BIZNESEVE NË %
RAJONI JUGPERËNDIM	1	GJAKOVË	10,213	476	73	403	78,699	130	4.66%	0.71%
	2	MALISHEVË	3,395	196	27	169	43,888	77	5.77%	0.80%
	3	RAHOVEC	4,007	174	21	153	41,799	96	4.34%	0.52%
	4	JUNIK	118	18	1	17	3,943	30	15.25%	0.85%
GJITHSEJ			**17,733**	**864**	**122**	**742**	**168,329**	**333**		

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TË BIZNESEVE TË REGJISTRUARA, TË REJA DHE TË SHUARA, DHE TREGUESIT RELATIVË TË ZHVILLIMIT TË BIZNESEVE SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUGPERËNDIM



SHTOJCA 6: BIZNESET E REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TË RAJONEVE ZHVILLIMORE

TABELA E REGJISTRIMEVE TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT QENDËR

RAJONET	NR.	KOMUNAT	BIZNESE TREGTARE – TË REJA	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË KOMUNAVE TË RAJONIT
RAJONI QENDËR	1	PRISHTINË	887	64%
	2	GLLOGOVC	57	4%
	3	FUSHË KOSOVË	172	12%
	4	GRAÇANICË	48	3%
	5	LIPJAN	77	6%
	6	OBILIQ	33	2%
	7	PODUJEVË	114	8%
GJITHSEJ			**1,388**	**100%**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT QENDËR




TABELA E REGJISTRIMEVE TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT VERI

RAJONET	NR.	KOMUNAT	BIZNESE TREGTARE – TË REJA	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË KOMUNAVE TË RAJONIT
RAJONI VERI	1	MITROVICË	108	30%
	2	SKENDERAJ	41	11%
	3	VUSHTRRI	93	26%
	4	MITROVICA E VERIUT	53	15%
	5	LEPOSAVIQ	32	9%
	6	ZVEQAN	16	4%
	7	ZUBIN POTOK	20	6%
GJITHSEJ			**363**	**100%**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT VERI




TABELA E REGJISTRIMEVE TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT PERËNDIM

RAJONET	NR.	KOMUNAT	BIZNESE TREGTARE – TË REJA	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË KOMUNAVE TË RAJONIT
RAJONI PERNDIM	1	PEJË	130	62%
	2	ISTOG	26	12%
	3	DEÇAN	24	11%
	4	KLINË	29	14%
GJITHSEJ			**209**	**100%**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT PERËNDIM




TABELA E REGJISTRIMEVE TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUG

RAJONET	NR.	KOMUNAT	BIZNESE TREGTARE – TË REJA	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË KOMUNAVE TË RAJONIT
RAJONI JUG	1	PRIZREN	289	78%
	2	DRAGASH	9	2%
	3	MAMUSHË	8	2%
	4	SUHAREKË	66	18%
GJITHSEJ			**372**	**100%**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUG




TABELA E REGJISTRIMEVE TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUGLINDJE

RAJONET	NR.	KOMUNAT	BIZNESE TREGTARE – TË REJA	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË KOMUNAVE TË RAJONIT
RAJONI JUGLINDJE	1	FERIZAJ	259	77%
	2	SHTIME	31	9%
	3	KAÇANIK	31	9%
	4	SHTËRPCË	6	2%
	5	HANI I ELEZIT	8	2%
GJITHSEJ			**335**	**100%**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUGLINDJE




TABELA E REGJISTRIMEVE TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT LINDJE

RAJONET	NR.	KOMUNAT	BIZNESE TREGTARE – TË REJA	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË KOMUNAVE TË RAJONIT
RAJONI LINDJE	1	GJILAN	193	74%
	2	VITI	36	14%
	3	NOVOBËRDË	-	0%
	4	KAMENICË	27	10%
	5	KLLOKOT	3	1%
	6	RANILLUGË	2	1%
	7	PARTESH	1	0%
GJITHSEJ			**262**	**100%**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT LINDJE




TABELA E REGJISTRIMEVE TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUGPERËNDIM

RAJONET	NR.	KOMUNAT	BIZNESE TREGTARE – TË REJA	% E PJESËMARRJËS NË NIVEL TË KOMUNAVE TË RAJONIT
RAJONI JUGPERËNDIM	1	GJAKOVË	107	58%
	2	MALISHEVË	26	14%
	3	RAHOVEC	44	24%
	4	JUNIK	6	3%
GJITHSEJ			**183**	**100%**

PARAQITJA GRAFIKE E NUMRIT TE BIZNESEVE TE REJA NË SEKTORIN E TREGTISË GJATË VITIT 2025 SIPAS KOMUNAVE TE RAJONIT JUGPERËNDIM

